



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 176

Tiranë – E premte, 7 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 75/2026, datë 23.7.2026	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 6.7.2026, “Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor-turistik me përmasa ndërkombëtare”..... 17861
Dekret i Presidentit nr. 479, datë 5.8.2026	Për shpallje ligji..... 17861
Ligj nr. 87/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”..... 17861
Dekret i Presidentit nr. 470, datë 4.8.2026	Për shpallje ligji..... 17882
Ligj nr. 89/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 173/2014, “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 17882
Dekret i Presidentit nr. 480, datë 5.8.2026	Për shpallje ligji..... 17885
Ligj nr. 90/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”..... 17885
Dekret i Presidentit nr. 481, datë 5.8.2026	Për shpallje ligji..... 17888
Dekret i Presidentit nr. 472, datë 4.8.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 17888
Dekret i Presidentit nr. 473, datë 4.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 17888
Dekret i Presidentit nr. 474, datë 4.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 17889

Dekret i Presidentit nr. 475, datë 4.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17889
Dekret i Presidentit nr. 477, datë 4.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17889
Dekret i Presidentit nr. 478, datë 4.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17890
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5, datë 17.7.2026	Për miratimin e formateve të raportimit periodik, të planit vjetor të punës, të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit.....	17890
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 181, datë 30.7.2026	Për miratimin e rregullores që përcakton rregullat e përbashkëta mbi menaxhimin e fluksit të trafikut ajror.....	17899
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 782, datë 29.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	17905
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 788, datë 30.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	17908
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 790, datë 31.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë.....	17909
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 791, datë 31.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Çekisë.....	17911
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 793, datë 3.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	17913
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 796, datë 4.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	17914
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 797, datë 4.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	17915
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 1593, datë 31.7.2026	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejd Joti.....	17916
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 1594, datë 31.7.2026	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda.....	17917

Urdhër i ministrit të Mbrojtjes
nr. 1595, datë 31.7.2026

Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave
zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana..... 17818

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Muhamet Virjoni..... 17819

**LIGJ**
Nr. 75/2026**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË
6.7.2026, “PËR FINANCIMIN E PJESSHËM
TË ORGANIZIMIT TË NJË AKTIVITETI
KULTUROR-TURISTIK ME PËRMASA
NDËRKOMBËTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 6.7.2026, “Për financimin e pjesshëm të organizimit dhe të mbarrëvajtjes së një aktiviteti kulturor-turistik me përmasa ndërkombëtare”.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 479, datë 5.8.2026 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me:

Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, mbi pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve, që ndryshon Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon Direktivat 78/660/KEE dhe 83/349/KEE të Këshillit. Numri CELEX: 32013L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 182, datë 29.6.2013, faqe 19–76;

Direktivën 2014/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 22 tetor 2014, që ndryshon Direktivën 2013/34/BE për sa i përket publikimit të informacionit jofinanciar dhe informacionit mbi diversitetin nga disa ndërmarrje të mëdha dhe grupe. Numri CELEX: 32014L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 330, datë 15.11.2014, faqe 1–9;

Direktivën (BE) 2021/2101 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 nëntor 2021, që ndryshon Direktivën 2013/34/BE për sa i përket publikimit të informacionit mbi tatimin mbi të ardhurat nga ndërmarrje dhe degë të caktuara. Numri CELEX: 32021L2101, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 429, datë 1.12.2021, faqe 1–17;

Direktivën (BE) 2022/2464 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 537/2014, Direktivën 2004/109/KE, Direktivën 2006/43/KE

DEKRET
Nr. 479, datë 5.8.2026**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 75/2026, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 6.7.2026, “Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor-turistik me përmasa ndërkombëtare””.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 87/2026**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 25/2018
“PËR KONTABILITETIN DHE
PASQYRAT FINANCIARE”¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

dhe Direktivën 2013/34/BE për sa i përket raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet (*Corporate Sustainability Reporting Directive* – CSRD). Numri CELEX: 32022L2464, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 322, datë 16.12.2022, faqe 15–80;

Direktivën e Deleguar (BE) 2023/2775 të Komisionit, datë 17 tetor 2023, që ndryshon Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për sa i përket përshtatjes së kriterëve të madhësisë për mikro, ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha ose grupet. Numri CELEX: 32023L2775, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 2023/2775, datë 21.12.2023;

Rregulloren (KE) nr. 1606/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 korrik 2002, për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Numri CELEX: 32002R1606, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 243, datë 11.9.2002, faqe 1–4;

Direktivën (BE) 2026/470 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 shkurt 2026, që ndryshon Direktivat 2006/43/KE, 2013/34/BE, (BE) 2022/2464 dhe (BE) 2024/1760 për sa u përket disa kërkesave për raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave dhe disa kërkesave për kujdesin e duhur të korporatave në fushën e qëndrueshmërisë. Numri CELEX: 32026L0470, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, OJ L 2026/470, datë 26.2.2026.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 1
Objekti**

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për hartimin dhe përbërësit e pasqyrave financiare, mbajtjen e kontabilitetit, përcaktimin e standardeve kontabël të raportimit financiar të zbatueshme, si dhe kërkesat për raportimin e qëndrueshmërisë nga njësitë ekonomike të përcaktuara në këtë ligj.”

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 4 fjalët “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” (SNFR)” zëvendësohen me fjalët “Standardet kontabël ndërkombëtare të raportimit financiar”.

2. Në pikën 17 fjalët “Monedhë e paraqitjes” zëvendësohen me fjalët “Monedhë raportuese”.

3. Pas pikës 18 shtohen pikat 19 deri 29 me këtë përmbajtje:

“19. “Palë e lidhur” ka të njëjtin kuptim si në standardet kontabël të raportimit financiar, që zbaton njësi ekonomike.

20. “Njësi ekonomike të lidhura” janë dy ose më shumë njësi brenda një grupi.

21. “Njësi ekonomike investimi” janë:

a) njësitë ekonomike, objekti i vetëm i të cilave është investimi i fondeve të tyre në tituj të ndryshëm, pasuri të paluajtshme dhe aktive të tjera, me qëllim të vetëm shpërndarjen e rreziqeve të investimit dhe dhënien e përfitimeve aksionarëve nga rezultatet e menaxhimit të këtyre aktiveve;

b) njësitë ekonomike pjesëmarrëse në njësitë ekonomike të investimit me kapital fikse, kur objekti

i vetëm i tyre është blerja e aksioneve të shlyera plotësisht të emetuara nga njësitë ekonomike të investimit, pa cenuar kufizimet ligjore për blerjen e aksioneve të veta nga shoqëritë aksionare, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

22. “Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë (SRQ)” janë standardet dhe udhëzimet e raportimit të qëndrueshmërisë, të miratuara nga Komisioni Evropian, të përkthyer në shqip, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, të shpallura të detyrueshme për zbatim me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

23. “Standardet vullnetare të raportimit të qëndrueshmërisë (SVRQ)” janë standardet dhe udhëzimet e raportimit të qëndrueshmërisë, të miratuara nga Komisioni Evropian, të destinuara për përdorim vullnetar nga njësitë ekonomike, që nuk i nënshtrohen detyrimit për raportim të qëndrueshmërisë, sipas këtij ligji. Standardet përkthehen zyrtarisht në gjuhën shqipe, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, dhe shpallen për zbatim me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

24. “Çështje të qëndrueshmërisë” janë faktorët mjedisorë, socialë, të të drejtave të njeriut, si dhe faktorët e qeverisjes, duke përfshirë çështjet kundër korrupsionit ose ryshfetit.

25. “Raportim i qëndrueshmërisë” përmban informacion për çështjet e qëndrueshmërisë, në përputhje me nenet 18/1, 20/1, 20/2 dhe 20/3 të këtij ligji.

26. Për qëllimet e neneve 18/2 dhe 20/2 termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Njësi ekonomike raportuese” nënkupton një njësi ekonomike/njësi ekonomike mëmë, që ka detyrimin të raportojë informacion të qëndrueshmërisë në përputhje me pikën 1 të nenit 18/1 dhe të nenit 20/1 të këtij ligji;

b) “Njësi ekonomike e mbrojtur” nënkupton një njësi ekonomike, e cila:

i. nuk tejkalon në datën e raportimit një numër mesatar prej 1000 punonjësish gjatë vitit financiar paraardhës;

ii. është pjesë e zinxhirit të vlerës së një njësie ekonomike raportuese.

c) “Standarde vullnetare” nënkupton standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të krijuara për përdorim vullnetar, sipas përkufizimit të përcaktuar në pikën 23 të nenit 3 të këtij ligji.



27. Për qëllimet e nenit 21 termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Institucion shtetëror” nënkupton çdo autoritet kombëtar, rajonal ose vendor, përfshirë agjencitë dhe njësitë e kontrolluara prej tyre, pavarësisht nëse i përkasin Republikës së Shqipërisë apo një shteti tjetër;

b) “Projekt” nënkupton aktivitetet operacionale që rregullohen nga një kontratë, licencë, marrëveshje qiraje, koncesion ose marrëveshje tjetër ligjore e ngjashme dhe përbëjnë bazën e detyrimeve të pagesave kundrejt një qeverie. Kur disa marrëveshje të tilla janë të ndërlidhura në mënyrë thelbësore, ato konsiderohen si një projekt i vetëm.

28. “Vend tjetër apo juridiksion tjetër” nënkupton çdo vend apo juridiksion:

a) jashtë Republikës së Shqipërisë deri në datën e anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian;

b) jashtë Bashkimit Evropian pas datës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

29. “Data e raportimit” ka të njëjtin kuptim si në standardet kontabël të raportimit financiar që zbaton njësia ekonomike.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Kudo në përmbajtjen e nenit fjalët “të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi)” zëvendësohen me fjalët “të ardhura të shfrytëzimit”.

2. Në pikën 3 fjalët “të ardhura nga veprimtaria ekonomike” zëvendësohen me fjalët “të ardhura të shfrytëzimit”.

3. Në pikën 4 togfjalëshi “në vitin 2028” hiqet.

4. Në pikën 5 fjalët “standardet kontabël të aplikueshme” zëvendësohen me fjalët “standardet kontabël të raportimit financiar të zbatueshme”.

5. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Pas përafrimit të plotë të kufijve, sipas pikës 4 të këtij neni, me kufijtë e parashikuar në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, për të rregulluar efektet e inflacionit ose kursit të këmbimit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të paktën një herë në 5 vjet të rishikojë dhe, kur është e nevojshme, të propozojë ndryshime ligjore në lidhje me:

a) kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni;

b) kufijtë që përcaktojnë fushën e zbatimit të kërkesave për raportimin e qëndrueshmërisë për njësitë ekonomike;

c) kufijtë që përcaktojnë fushën e zbatimit të kërkesave për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë për grupet e njësive ekonomike.”.

Neni 4

Në pikën 2 të nenit 5 fjalët “duhet të” hiqen.

Neni 5

Në nenin 6 fjalët “standardeve kontabël të aplikueshme” zëvendësohen me fjalët “standardeve kontabël të raportimit financiar të zbatueshme”.

Neni 6

Në pikën 3 të nenit 9 fjala “gjithsesi” hiqet.

Neni 7

Në nenin 11 fjalët “standardet e aplikueshme të raportimit financiar” zëvendësohen me fjalët “standardet kontabël të raportimit financiar të zbatueshme”.

Neni 8

Në nenin 12 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët “sipas standardeve kontabël të raportimit financiar të zbatueshme”.

2. Në pikën 2 fjalët “raport drejtimi të konsoliduar” zëvendësohen me fjalët “raport të konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përjashtimet nga detyrimi për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe të raportit të konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, të përcaktuara në këtë ligj, zbatohen për atë kohë sa nuk cenohen detyrimet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni vendas në fuqi, kur:

a) këto dokumente kërkohen për informimin e punëmarrësve ose të përfaqësuesve të tyre; ose

b) këto dokumente kërkohen nga një autoritet administrativ ose gjyqësor për qëllimet e veta.”.



Neni 9

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

**Kërkesa për përgatitjen e pasqyrave
financiare të konsoliduara**

1. Çdo njësi ekonomike, përveç atyre të përjashtuara, sipas nenit 12 të këtij ligji, e rregulluar nga legjislacioni shqiptar, harton pasqyra financiare të konsoliduara dhe një raport të konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë kur kjo njësi:

a) zotëron shumicën e të drejtave të votës së aksionarëve ose anëtarëve të një njësie tjetër (njësi e kontrolluar);

b) ka të drejtë të emërojë ose të largojë shumicën e anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese ose mbikëqyrëse të një njësie tjetër (njësi e kontrolluar) dhe është në të njëjtën kohë aksionare ose anëtare në atë njësi;

c) ka të drejtë të ushtrojë kontroll përmes një ndikimi dominues mbi një njësi të kontrolluar në të cilën është aksionare ose anëtare në bazë të një kontrate të lidhur me atë njësi ose të një dispozite në aktin e themelimit apo statutin e saj, kur legjislacioni i njësisë së kontrolluar e lejon një marrëdhënie të tillë;

ç) është aksionare ose anëtare e një njësie tjetër dhe:

i. shumica e anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese ose mbikëqyrëse të asaj njësie, të cilët kanë ushtruar funksionin e tyre gjatë vitit financiar, gjatë vitit financiar të mëparshëm dhe deri në kohën e hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara, janë emëruar vetëm si rezultat i ushtrimit të të drejtave të saj të votës; ose

ii. kontrollon e vetme shumicën e të drejtave të votës së aksionarëve ose anëtarëve të asaj njësie, në përputhje me një marrëveshje me aksionarët ose anëtarët e tjerë të asaj njësie.

Nënndarja “i” e shkronjës “ç” të kësaj pike nuk zbatohet kur të drejtat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” ose “c” të kësaj pike, në lidhje me atë njësi, zotërohen nga një palë e tretë.

2. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, njësia ekonomike harton pasqyra financiare të konsoliduara dhe një raport të konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë edhe kur:

a) kjo njësi ekonomike (mëma) ka kompetencën të ushtrojë ose ushtron faktikisht kontroll, përmes një ndikimi dominues, mbi një njësi tjetër (njësi e kontrolluar); ose

b) kjo njësi ekonomike (mëma) dhe një njësi ekonomike tjetër (njësi e kontrolluar) drejtohen në mënyrë të unifikuar nga kjo njësi ekonomike mëmë.

3. Për qëllimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, të drejtat e votës dhe të drejtat e emërimit apo largimit që zotërohen nga një njësi e kontrolluar tjetër ose nga çdo person që vepron në emër të vet, por për llogari të njësisë mëmë ose të një njësie tjetër të kontrolluar, u shtohen të drejtave të njësisë mëmë.

4. Për qëllimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, të drejtat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni nuk zbatohen kur ato burojnë nga:

a) aksione të mbajtura për llogari të një personi që nuk është as njësi mëmë, as njësi e kontrolluar e saj; ose

b) aksione, të cilat:

i. mbahen si kolateral, nëse të drejtat ushtrohen sipas udhëzimeve të dhëna; ose

ii. mbahen për dhënien e huave, si pjesë e veprimtarisë së zakonshme të biznesit, nëse të drejtat e votës ushtrohen në interes të personit që ka siguruar kolateralin.

5. Për qëllimet e shkronjave “a” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, totali i të drejtave të votës së aksionarëve ose anëtarëve në njësinë e kontrolluar reduktohet duke përjashtuar të drejtat e votës që burojnë nga aksionet e mbajtura nga vetë ajo njësi, nga njësitë e saj të kontrolluara ose nga persona që veprojnë në emër të vet, por për llogari të tyre.

6. Rregullat e hollësishme për vlerësimin, paraqitjen dhe metodat e konsolidimit përcaktohen nga standardet kontabël të zbatueshme të raportimit financiar.”.

Neni 10

Në pikën 1 të nenit 13 fjalët “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” zëvendësohen me “standardet kontabël ndërkombëtare të raportimit financiar”.

Neni 11

Pika 1 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:



“1. Njësitet ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve e të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse.”.

Neni 12

Në nenin 16 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Kudo në përmbajtjen e nenit fjalët “standartet kontabël të aplikueshme” zëvendësohen me fjalët “standartet kontabël të raportimit financiar të zbatueshme”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Të gjitha njësitet ekonomike, përtej kërkesave të parashikuara në standartet kontabël të raportimit financiar të zbatueshme, në shënimet shpjeguese duhet të paraqesin edhe:

a) numrin mesatar të punëmarrësve gjatë periudhës raportuese;

b) shumën e paradhënieve dhe kredive të dhëna anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse, duke specifikuar normat e interesit, kushtet kryesore, si dhe të gjitha shumat e shlyera, të fshira ose të hequra dorë, si edhe angazhimet e ndërmarra në emër të tyre përmes garancive të çdo lloji, me specifikimin e totalit për secilën kategori;

c) shumat që duhet të paguhën nga njësia ekonomike dhe që janë të detyrueshme për pagesë pas më shumë se 5 vjetësh, si dhe të gjitha detyrimet e saj, të siguruara me garanci të dhëna nga vetë njësia ekonomike, duke specifikuar natyrën dhe formën e garancisë.”.

3. Në shkronjën “c” të pikës 3 fjalët “Sa më sipër” zëvendësohen me fjalët “Përfshirë nga përcaktimet në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të kësaj pike”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Të gjitha njësitet ekonomike duhet të japin informacion për kategoritë kryesore të të ardhurave të shfrytëzimit, të ndara sipas llojit të aktivitetit ekonomik.”.

Neni 13

Në nenin 17 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “Njësitet ekonomike” zëvendësohen me fjalët “Njësitet ekonomike fitimprurëse”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Njësitet ekonomike, të cilat në datën e raportimit tejkalojnë vlerën prej 45 000 000 000 lekësh të të ardhurave të shfrytëzimit dhe kanë një numër mesatar prej më shumë se 1 000 punonjësish gjatë vitit financiar, raportojnë informacion për aktivet e tyre jomateriale dhe shpjegojnë se si modeli i biznesit të njësisë ekonomike varet në mënyrë thelbësore nga këto aktive dhe si këto aktive përbëjnë një burim të krijimit të vlerës për njësinë ekonomike.”.

3. Shkronja “c” e pikës 3 shfuqizohet.

Neni 14

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “janë me interes publik dhe” hiqen.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, bazuar në standartet ndërkombëtare të auditimit dhe sigurisë, të shpallura të detyrueshme për zbatim, japin siguri për raportin jofinanciar të hartuar nga njësitet ekonomike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”.

Neni 15

Pas nenit 18 shtohen nenet 18/1 dhe 18/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

Raportimi i qëndrueshmërisë

1. Njësitet ekonomike, të cilat në datën e raportimit tejkalojnë njëkohësisht një mesatare vjetore prej 1 000 punonjësish dhe të ardhura të shfrytëzimit prej 45 000 000 000 lekësh gjatë vitit financiar, duhet të përfshijnë në raportin e ecursisë së veprimtarisë informacionin e nevojshëm për të kuptuar ndikimet e veprimtarisë së njësisë ekonomike për çështjet e qëndrueshmërisë, si dhe informacionin e nevojshëm për të kuptuar se si çështjet e qëndrueshmërisë ndikojnë në zhvillimin, performancën dhe pozicionin e njësisë ekonomike.



2. Raporti i qëndrueshmërisë përmban:

a) përshkrim të modelit dhe strategjisë së biznesit të njësisë, duke përfshirë:

i. fleksibilitetin e tyre ndaj rreziqeve që lidhen me çështjet e qëndrueshmërisë;

ii. mundësitë në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë;

iii. planet e njësisë, përfshirë masat zbatuese dhe planet financiare e të investimeve, për të siguruar harmonizimin e modelit dhe strategjisë me kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe me kufizimin e ngrohjes globale në 1,5°C, në pajtueshmëri me marrëveshjen e Parisit, sipas Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, si dhe objektivat afatgjatë të neutralitetit klimatik dhe, sipas rastit, ekspozimin e njësisë ndaj veprimtarive të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin;

iv. mënyrën se si merren parasysh interesat e grupeve të interesit dhe ndikimet e njësisë në çështjet e qëndrueshmërisë;

v. mënyrën e zbatimit të strategjisë për çështjet e qëndrueshmërisë.

b) përshkrim të objektivave të përcaktuar nga njësia në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë, duke përfshirë objektivat për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serë, të paktën për vitet 2030 dhe 2050, progresin e bërë drejt arritjes së tyre, si dhe një deklaratë ku të specifikohet nëse këta objektiva në lidhje me faktorët mjedisorë bazohen në të dhëna shkencore të verifikuara;

c) përshkrim të rolit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë, si dhe të ekspertizës dhe aftësive të tyre në këtë drejtim;

ç) përshkrim të politikave të ndjekura nga njësia për çështjet e qëndrueshmërisë;

d) informacion për ekzistencën e skemave nxitëse lidhur me çështjet e qëndrueshmërisë për anëtarët e organeve drejtuese e mbikëqyrëse;

dh) përshkrim të:

i. procesit të kujdesit të duhur, të zbatuar nga njësia për çështjet e qëndrueshmërisë;

ii. ndikimeve kryesore negative, aktuale ose të mundshme, që lidhen me veprimtarinë e saj dhe zinxhirin e vlerës, duke përfshirë produktet, shërbimet, marrëdhëniet e biznesit dhe zinxhirin e saj të furnizimit, si dhe masat e marra për t'i identifikuar, për t'i monitoruar dhe për t'i menaxhuar ato;

iii. masave të marra për të parandaluar, për të zbutur, për të korrigjuar ose për të eliminuar ndikimet negative, aktuale ose të mundshme, dhe rezultatet e këtyre masave.

e) përshkrim të rreziqeve kryesore lidhur me çështjet e qëndrueshmërisë, përfshirë ndërvarësitë kryesore të njësisë dhe mënyrën e menaxhimit të tyre;

ë) treguesit kryesorë të performancës për çështjet e raportuara në shkronjat “a” deri në “e” të kësaj pike.

Njësitë ekonomike raportojnë procesin e ndjekur për identifikimin e informacionit të përfshirë në raportin e ecures së veprimtarisë, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Ky informacion përfshin, sipas rastit, të dhëna që lidhen me periudha kohore afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

3. Kur raporton informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, njësia ekonomike mund të mos përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) në raste të jashtëzakonshme, informacionin, dhënia e të cilit do të dëmtonte rëndë pozitën tregtare të njësisë ekonomike, me kusht që:

i. një mospërfshirje e tillë të mos pengojë një kuptim të drejtë dhe të ekuilibruar të zhvillimit, performancës dhe pozicionit të njësisë ekonomike ose të rreziqeve kryesore apo ndikimeve kryesore të saj;

ii. njësia ekonomike të ketë vlerësuar se informacioni nuk mund të jepet në një mënyrë që do të përmbushte objektivat e kërkesës për dhënie informacioni, pa dëmtuar rëndë pozitën e saj tregtare, duke përfshirë, sipas rastit, edhe dhënien e tij në formë të agreguar;

iii. njësia ekonomike të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

iv. njësia ekonomike të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.

b) informacionin që lidhet me kapitalin intelektual, pronësinë intelektuale, njohuritë e specializuara, informacionin teknologjik ose rezultatet e inovacionit, të cilat përbëjnë sekret tregtar, sipas legjislacionit në fuqi, me kusht që:

i. njësia ekonomike të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

ii. njësia ekonomike të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.



c) informacionin e klasifikuar sipas legjislacionit të zbatueshëm, me kusht që:

i. njësia ekonomike të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

ii. njësia ekonomike të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet;

ç) informacione të tjera që duhet të mbrohen nga aksesimi ose përhapja e paautorizuar, për shkak të detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi ose për të mbrojtur privatësinë apo sigurinë e një personi fizik ose sigurinë e një personi juridik, me kusht që:

i. njësia ekonomike të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

ii. njësia ekonomike të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.

4. Drejtuesit e njësive informojnë përfaqësuesit e punonjësve dhe diskutojnë me ta informacionin për çështjet e qëndrueshmërisë dhe mjetet e sigurimit e verifikimit të tij. Opinioni i përfaqësuesve të punonjësve u komunikohet, sipas rastit, organeve përkatëse ekzekutive, drejtuese ose mbikëqyrëse.

5. Raporti i qëndrueshmërisë, i përgatitur në përputhje me pikat 1 deri 4 të këtij neni, si dhe raportimi i kufizuar, i parashikuar për njësitë e përfshira në pikën 6 të këtij neni, konsiderohen se plotësojnë detyrimin për raportimin e informacionit, të parashikuar në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji.

6. Njësitë ekonomike të kontrolluara përjashtohen nga detyrimi për të hartuar raport të veçantë të qëndrueshmërisë, nëse ato dhe njësitë e tyre të kontrolluara përfshihen në raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë ose në raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë së njësive mëmë të përgatitur në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë ose standardeve të barasvlershme me to, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore për njohjen e barasvlershmërisë së këtyre standardeve.

Një njësi e kontrolluar e një njësie mëmë, kur kjo e fundit është e themeluar në një juridiksion tjetër, përjashtohet gjithashtu nga ky detyrim, nëse ajo dhe njësitë e saj të kontrolluara përfshihen në raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë të përgatitur nga njësia mëmë në atë juridiksion dhe ky raport përgatitet në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë ose standardeve të barasvlershme

me to, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore për njohjen e barasvlershmërisë së këtyre standardeve.

Përjashtimi në këtë pikë është objekt i kushteve të mëposhtme:

a) raporti i ecurisë së veprimtarisë së njësive së kontrolluar që përjashtohet përmban:

i. emrin dhe selinë e regjistruar të njësive mëmë që raporton;

ii. lidhjen në *web* që drejton te raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar i njësive mëmë dhe te opinionin e dhënies së sigurisë për raportin;

iii. deklarin se njësia është e përjashtuar nga detyrimi për raportim të veçantë të qëndrueshmërisë.

b) kur njësia mëmë është themeluar në një juridiksion tjetër, raporti i saj i qëndrueshmërisë i konsoliduar dhe opinionin e dhënies së sigurisë për raportin e qëndrueshmërisë së konsoliduar publikohen në përputhje me legjislacionin vendas për publikimin e pasqyrave financiare dhe në përputhje me legjislacionin e shtetit, ku është regjistruar njësia e kontrolluar e përjashtuar.

Neni 18/2

Informacioni në lidhje me zinxhirin e vlerës për qëllimet e raportimit të qëndrueshmërisë

1. Kur është e zbatueshme, informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 të nenit 18/1 të këtij ligji duhet të përfshijë informacion në lidhje me veprimtarinë e vetë njësive ekonomike dhe zinxhirin e saj të vlerës, duke përfshirë produktet dhe shërbimet e saj, marrëdhëniet e saj të biznesit dhe zinxhirin e saj të furnizimit.

2. Njësitë ekonomike raportuese mund të mbështeten në një vetëdeklarim nga njësitë ekonomike në zinxhirin e tyre të vlerës për të përcaktuar nëse ato kualifikohen si njësi ekonomike të mbrojtura. Njësitë ekonomike raportuese nuk kanë detyrimin të ndërmarrin hapa për të verifikuar informacionin e përfshirë në një vetëdeklarim të tillë. Ato nuk duhet të mbështeten në vetëdeklarim nëse e dinë ose mund të pritë në mënyrë të arsyeshme të dinë se deklarata është qartazi e pasaktë.

3. Njësitë ekonomike të mbrojtura kanë të drejtën të refuzojnë dhënien e informacionit që tejkalon informacionin e specifikuar në standardet vullnetare, në përgjigje të një kërkesë të bërë për qëllime të raportimit të qëndrueshmërisë, sipas këtij ligji. Për më tepër:



a) kur vendosen marrëveshje kontraktuale ose të tjera për qëllime të përmbushjes së kërkesave të raportimit të qëndrueshmërisë, sipas këtij ligji, njësitë ekonomike raportuese nuk duhet të kërkojnë nga njësitë ekonomike të mbrojtura të japin informacion që tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare;

b) çdo dispozitë kontraktuale që bie ndesh me shkronjën “a” të kësaj pike nuk do të jetë detyruese, pa cenuar vlefshmërinë e pjesëve të tjera të kontratës;

c) kur një njësi ekonomike raportuese kërkon informacion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga njësi ekonomike të mbrojtura, për qëllime të raportimit të qëndrueshmërisë, dhe një pjesë ose i gjithë ai informacion tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare, ajo njësi ekonomike raportuese duhet të sigurojë që njësia ekonomike e mbrojtur të informohet për:

i. informacionin që tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare;

ii. të drejtën ligjore të njësisë ekonomike të mbrojtur për të refuzuar dhënien e këtij informacioni.

ç) njësitë ekonomike raportuese, të cilat raportojnë informacionin e nevojshëm në lidhje me zinxhirin e tyre të vlerës, pa u kërkuar njërive ekonomike të mbrojtura të japin informacion që tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare, konsiderohen se kanë përmbushur detyrimin për të raportuar informacionin në lidhje me zinxhirin e vlerës.

4. Dispozitat e këtij neni nuk duhet:

a) të ndikojnë në kërkesat për informacion, të bëra për qëllime të tjera nga raportimi i qëndrueshmërisë, sipas këtij ligji, përfshirë kërkesat për përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me proceset e kujdesit të duhur; ose

b) të vendosin ose të nënkuptojnë ndonjë detyrim për ndonjë njësi ekonomike në zinxhirin e vlerës për të dhënë informacion për qëndrueshmërinë.

5. Për 3 vjetët e para, gjatë të cilave një njësi ekonomike bëhet subjekt i kërkesave të raportimit të qëndrueshmërisë, në përputhje me pikën 1 të nenit 18/1 të këtij ligji, dhe kur jo i gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me zinxhirin e saj të vlerës është i disponueshëm, njësia ekonomike duhet:

a) të shpjegojë përpjekjet e bëra për të siguruar informacionin e nevojshëm në lidhje me zinxhirin e vlerës;

b) të shpjegojë arsyet pse nuk është siguruar i gjithë informacioni i nevojshëm;

c) të përshkruajë planet e saj për të siguruar informacionin në të ardhmen.

6. Pas përfundimit të periudhës tranzitore 3-vjeçare, të përmendur në pikën 5 të këtij neni, njësia ekonomike duhet të përmbushë detyrimin për të raportuar informacionin në lidhje me zinxhirin e vlerës, duke përdorur informacion të marrë drejtpërdrejt nga njësi ekonomike, brenda zinxhirit të saj të vlerës ose, sipas rastit, vlerësime të këtij informacioni.”.

Neni 16

Në pikën 1 të nenit 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalëve “Njësitë ekonomike me interes publik” shtohen fjalët “përrjashtuar mikronjësitë”.

2. Në shkronjën “a” pas nënndarjes “iii” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur përfshihen referenca të kodit për drejtimin e brendshëm, të përmendura në nënndarjet “i” ose “ii” të kësaj shkronje, njësia ekonomike përcakton edhe se ku gjenden të publikuara tekstet përkatëse. Kur përfshihen referenca të informacionit, të përmendura në nënndarjen “iii” të kësaj shkronje, njësia ekonomike vë në dispozicion të publikut detaje të praktikave të saj të drejtimit të brendshëm;

3. Në shkronjën “ç” bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) fjala “të ndryshme” zëvendësohet me fjalën “të diversitetit”;

b) në fund të shkronjës shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Nëse nuk zbatohet një politikë e tillë, raporti duhet të përmbajë një shpjegim të arsyeve përkatëse. Njësitë ekonomike që përgatitin raport mbi qëndrueshmërinë, në përputhje me këtë ligj, konsiderohen se e kanë përmbushur këtë detyrim kur informacioni i kërkuar përfshihet në atë raport dhe bëhet referencë për të në raportin e drejtimit të brendshëm.”.



Neni 16/1

Në nenin 20 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kur krahas raportit të ecuresë së veprimtarisë kërkohet gjithashtu një raport i konsoliduar i ecuresë së veprimtarisë, të dyja raportet mund të paraqiten si një raport i vetëm.

Neni 17

Pas nenit 20 shtohen nenet 20/1 deri 20/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Raportimi i qëndrueshmërisë i konsoliduar

1. Njësitë ekonomike mëmë të një grupi, të cilat në datën e raportimit, në bazë të konsoliduar, tejkalojnë njëkohësisht të ardhura neto prej 45 000 000 000 lekësh dhe një mesatare vjetore prej 1 000 punonjësish gjatë vitit financiar, duhet të përgatisin dhe të përshijjnë në raportin e konsoliduar të ecuresë së veprimtarisë informacionin e nevojshëm për të kuptuar:

a) ndikimet e veprimtarive të grupit për çështjet e qëndrueshmërisë;

b) mënyrën se si çështjet e qëndrueshmërisë ndikojnë në zhvillimin, performancën dhe pozicionin e grupit.

Informacioni i përmendur në këtë pikë duhet të jetë qartësisht i identifikueshëm brenda raportit të konsoliduar të ecuresë së veprimtarisë, nëpërmjet një seksioni të dedikuar të këtij raporti.

2. Raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar përmban:

a) përshkrim të modelit dhe strategjisë së biznesit të grupit, duke përfshirë:

i. fleksibilitetin e modelit dhe strategjisë së biznesit të grupit për sa u përket rreziqeve që lidhen me çështjet e qëndrueshmërisë;

ii. mundësitë për grupin në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë;

iii. planet e grupit, përfshirë masat zbatuese dhe planet financiare të investimeve, për të siguruar harmonizimin e modelit dhe strategjisë, me kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe me kufizimin e ngrohjes globale në 1,5°C, në pajtueshmëri me marrëveshjen e Parisit dhe me objektivin e arritjes së neutralitetit klimatik deri në

vitin 2050, dhe, sipas rastit, ekspozimin e grupit ndaj veprimtarive të lidhura me qymyrin, naftën dhe gazin;

iv. mënyrën se si modeli dhe strategjia e biznesit të grupit marrin parasysh interesat e grupeve të interesit dhe ndikimet e grupit në çështjet e qëndrueshmërisë;

v. mënyrën e zbatimit të strategjisë së grupit në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë.

b) përshkrim të objektivave të përcaktuar nga grupi lidhur me çështjet e qëndrueshmërisë, përfshirë, sipas rastit, objektivat e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për periudhat afatmesme dhe afatgjata, progresin drejt arritjes së tyre dhe një deklaratë, ku të cilësohet nëse objektivat e grupit në lidhje me faktorët mjedisorë bazohen në të dhëna shkencore të verifikuara;

c) përshkrim të rolit të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse, në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë, si dhe të ekspertizës dhe aftësive të tyre në këtë drejtim;

ç) përshkrim të politikave të ndjekura nga grupi për çështjet e qëndrueshmërisë;

d) informacion për ekzistencën e skemave nxitëse lidhur me çështjet e qëndrueshmërisë për anëtarët e organeve ekzekutive, drejtuese e mbikëqyrëse;

dh) përshkrim të:

i. procesit të kujdesit të duhur, të zbatuar nga grupi për çështjet e qëndrueshmërisë;

ii. ndikimeve kryesore negative, aktuale ose të mundshme, që lidhen me veprimtarinë e tij dhe zinxhirin e vlerës, duke përfshirë produktet, shërbimet, marrëdhëniet e biznesit dhe zinxhirin e saj të furnizimit, si dhe masat e marra për t'i identifikuar, për t'i monitoruar dhe për t'i menaxhuar ato;

iii. çdo mase të ndërmarrë nga grupi për të parandaluar, për të zbutur, për të korrigjuar ose për të eliminuar ndikimet negative, aktuale ose të mundshme, dhe të rezultatit të këtyre masave.

e) përshkrim të rreziqeve kryesore për grupin, sa u përket çështjeve të qëndrueshmërisë, duke përfshirë ndërvarësitë kryesore nga këto çështje dhe mënyrën e menaxhimit të rreziqeve;

ë) treguesit kryesorë të performancës për çështjet e raportuara në shkronjat “a” deri në “e” të kësaj pike.

Raporti pasqyron të dhëna afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, sipas rastit.



3. Kur raporton informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, njësia ekonomike mëmë mund të mos përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) në raste të jashtëzakonshme, informacionin, dhënia e të cilit do të dëmtonte rëndë pozitën tregtare të grupit, me kusht që:

i. një mospërfshirje e tillë të mos pengojë një kuptim të drejtë dhe të ekuilibruar të zhvillimit, performancës dhe pozicionit të grupit ose të rrezeve kryesore apo ndikimeve kryesore të tij;

ii. njësia ekonomike mëmë të ketë vlerësuar se informacioni nuk mund të jepet në një mënyrë që do të lejonte përmbushjen e objektivave të kërkesës për dhënie informacioni, pa dëmtuar rëndë pozitën tregtare të grupit, duke përfshirë, sipas rastit, edhe dhënien e tij në formë të agreguar;

iii. njësia ekonomike mëmë të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

iv. njësia ekonomike mëmë të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.

b) informacionin që lidhet me kapitalin intelektual, pronësinë intelektuale, njohuritë e specializuara, informacionin teknologjik ose rezultatet e inovacionit, të cilat përbëjnë sekret tregtar, sipas legjislacionit në fuqi, me kusht që:

i. njësia ekonomike mëmë të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

ii. njësia ekonomike mëmë të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.

c) informacionin e klasifikuar, sipas legjislacionit të zbatueshëm, me kusht që:

i. njësia ekonomike mëmë të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

ii. njësia ekonomike mëmë të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.

c) informacione të tjera që duhet të mbrohen nga aksesit ose nga përhapja e paautorizuar për shkak të detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi ose për të mbrojtur privatësinë apo sigurinë e një personi fizik ose sigurinë e një personi juridik, me kusht që:

i. njësia ekonomike mëmë të bëjë të ditur se ka përdorur këtë përjashtim;

ii. njësia ekonomike mëmë të rivlerësojë në çdo datë raportimi nëse informacioni mund të vazhdojë të mos përfshihet.

4. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, kur përbërja e grupit ndryshon gjatë vitit financiar si rezultat i blerjes ose bashkimit të njësive ekonomike, njësia ekonomike mëmë mund të vendosë të mos përfshijë në raportin e konsoliduar të ecuresë së veprimtarisë për atë vit financiar informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni në lidhje me njësitë ekonomike, që janë subjekt i kësaj blerjeje ose bashkimi.

Njësia ekonomike mëmë mund të vendosë të mos përfshijë në raportin e konsoliduar të ecuresë së veprimtarisë informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, në lidhje me një njësi ekonomike të kontrolluar që del nga grupi gjatë vitit financiar.

Njësia ekonomike mëmë, e cila zbaton mundësitë e parashikuara në këtë pikë, duhet të japë informacion për çdo ngjarje të rëndësishme që prek njësinë ekonomike të kontrolluar gjatë vitit financiar dhe ka efekt mbi ndikimet e grupit për çështjet e qëndrueshmërisë ose në rreziqet apo mundësitë që lidhen me to.

5. Raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar përgatitet në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të shpallura për zbatim me urdhër nga ministri përgjegjës për financat.

6. Drejtuesit e njësive mëmë informojnë përfaqësuesit e punonjësve në nivelin e duhur dhe diskutojnë me ta informacionin përkatës dhe mjetet e sigurimit e verifikimit të informacionit lidhur me qëndrueshmërinë. Opinioni i përfaqësuesve të punonjësve u komunikohet, sipas rastit, organeve kompetente ekzekutive, drejtuese ose mbikëqyrëse.

7. Njësia mëmë, që përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 1 deri në 5 të këtij neni, konsiderohet se ka përmbushur kërkesat për përfshirjen e informacionit përkatës në raportin e konsoliduar të ecuresë së veprimtarisë dhe në raportimin e qëndrueshmërisë në nivel grupi, sipas këtij ligji.

8. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, njësitë ekonomike mëmë, që janë njësi ekonomike të tipit “shoqëri financiare *holding*”, mund të vendosin të mos përfshijnë në raportin e konsoliduar të ecuresë së veprimtarisë informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, kur modelet e biznesit dhe veprimtaritë e njësive ekonomike të kontrolluara janë të pavarura nga njëra-tjetra.

9. Njësia mëmë përjashtohet nga detyrimi për të hartuar raport të konsoliduar të qëndrueshmërisë, kur ajo vetë është njësi e kontrolluar dhe përfshihet,



së bashku me njësitë e saj të kontrolluara, në raportin e konsoliduar të ecures së veprimtarisë ose në raportin e qëndrueshmërisë të konsoliduar të një njësie mëmë tjetër, të përgatitur në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë ose standardeve të barasvlershme me to, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore për njohjen e barasvlefshmërisë së këtyre standardeve. Përfshirimi vlen edhe kur njësia mëmë tjetër është e themeluar në një juridiksion tjetër, me kusht që raporti i saj i qëndrueshmërisë i konsoliduar të jetë i përgatitur sipas standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë ose sipas standardeve të barasvlershme me to, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore për njohjen e barasvlershmërisë së këtyre standardeve. Përfshirimi zbatohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) raporti i ecures së veprimtarisë së njësisë mëmë të përfshiruar përmban:

i. emrin dhe selinë e regjistruar të njësisë mëmë që raporton në nivel grupi;

ii. lidhjen në *web* që drejton te raporti i konsoliduar i ecures së veprimtarisë së njësisë mëmë ose, sipas rastit, te raporti i saj i qëndrueshmërisë i konsoliduar, si dhe tek opinioni i dhënies së sigurisë për raportin;

iii. deklarin se njësia mëmë është e përfshiruar nga detyrimi për raportim të konsoliduar të qëndrueshmërisë, sipas kësaj pike.

b) kur njësia mëmë është themeluar në një juridiksion tjetër, raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar dhe opinioni i dhënies së sigurisë publikohen në përputhje me kërkesat e këtij ligji për publikimin dhe me legjislacionin e shtetit ku është regjistruar njësia mëmë e përfshiruar;

c) kur njësia mëmë është themeluar në një juridiksion tjetër, raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar përfshin edhe deklarinimet për veprimtaritë e njësisë të kontrolluara, sipas kërkesave të legjislacionit për klasifikimin e aktiviteteve të qëndrueshme.

10. Raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar, hartuar sipas përcaktimeve të pikës 22 të nenit 3 të këtij ligji, dhe, sipas rastit, përkthimet përkatëse publikohen në gjuhën shqipe dhe çdo përkthim i pacertifikuar shoqërohet me deklaratën përkatëse.

11. Njësitë mëmë të përfshiruar nga përgatitja e raportit të ecures së veprimtarisë nuk janë të detyruara të përfshijnë informacionin e përcaktuar në nënndarjet “i” deri në “iii” të shkronjës “a” të

pikës 9 të këtij neni, me kusht që të publikojnë raportin e konsoliduar të ecures së veprimtarisë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Për qëllimet e kësaj pike, institucionet e kreditit, të lidhura në mënyrë të përhershme me një organ qendror që i mbikëqyr, trajtohen si njësi të kontrolluara të atij organi qendror, sipas legjislacionit përkatës. Për grupet e përfshira në sektorin e sigurimeve, të cilat i nënshtrohen mbikëqyrjes së grupit, sipas legjislacionit për sigurimet, njësitë trajtohen si të kontrolluara të njësisë mëmë të grupit.

Përfshirimi i përcaktuar në këtë pikë vlen edhe për njësitë me interes publik.

Neni 20/2

Informacioni për zinxhirin e vlerës për qëllimet e raportimit të konsoliduar të qëndrueshmërisë

1. Kur është i zbatueshëm, informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 të nenit 20/1 të këtij ligji duhet të përfshijë informacion në lidhje me veprimtarinë e vetë grupit dhe zinxhirin e tij të vlerës, duke përfshirë produktet dhe shërbimet e tij, marrëdhëniet e tij të biznesit dhe zinxhirin e furnizimit.

2. Njësitë ekonomike raportuese mund të mbështeten në një vetëdeklarim nga njësi ekonomike në zinxhirin e tyre të vlerës, për të përcaktuar nëse ato kualifikohen si njësi ekonomike të mbrojtura. Ato nuk kanë detyrimin të verifikojnë informacionin e përfshirë në vetëdeklarim dhe nuk duhet të mbështeten në vetëdeklarim kur e dinë ose mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të dinë se deklarata është qartazi e pasaktë.

3. Njësitë ekonomike të mbrojtura kanë të drejtën të refuzojnë dhënien e informacionit që tejkalon informacionin e specifikuar në standardet vullnetare, në përgjigje të një kërkesë të bërë, për qëllime të raportimit të konsoliduar të qëndrueshmërisë, sipas këtij ligji. Për më tepër:

a) kur vendosen marrëveshje kontraktuale ose të tjera për të përmbushur kërkesat e raportimit të konsoliduar të qëndrueshmërisë, njësitë ekonomike raportuese nuk duhet të kërkojnë nga njësitë ekonomike të mbrojtura të japin informacion që tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare;



b) çdo dispozitë kontraktuale që bie ndesh me shkronjën “a” të kësaj pike nuk do të ketë fuqi detyruese, pa cenuar vlefshmërinë e pjesëve të tjera të kontratës;

c) kur një njësi ekonomike raportuese kërkon informacion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga njësi ekonomike të mbrojtura për qëllime të raportimit të konsoliduar të qëndrueshmërisë dhe një pjesë ose i gjithë ai informacion tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare, ajo duhet të sigurojë që njësia ekonomike e mbrojtur të informohet për:

i. informacionin që tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare;

ii. të drejtën ligjore të njësisë ekonomike të mbrojtur për të refuzuar dhënien e këtij informacioni.

ç) njësitë ekonomike raportuese të cilat raportojnë informacionin e nevojshëm në lidhje me zinxhirin e tyre të vlerës, pa u kërkuar njësi ekonomike të mbrojtura të japin informacion që tejkalon informacionin e përcaktuar në standardet vullnetare, konsiderohen se kanë përmbushur detyrimin për të raportuar informacionin në lidhje me zinxhirin e vlerës.

4. Dispozitat e këtij neni nuk duhet:

a) të ndikojnë në kërkesat për informacion të bëra për qëllime të tjera nga raportimi i konsoliduar i qëndrueshmërisë, sipas këtij ligji, përfshirë kërkesat e lidhura me procesin e kujdesit të duhur; ose

b) të vendosin ose të nënkuptojnë ndonjë detyrim për ndonjë njësi ekonomike brenda zinxhirit të vlerës për të dhënë informacion për qëndrueshmërinë.

5. Për 3 vjetët e parë gjatë të cilëve një njësi ekonomike mëmë bëhet subjekt i kërkesave të raportimit të konsoliduar të qëndrueshmërisë, në përputhje me pikën 1 të nenit 20/1 të këtij ligji, dhe kur jo i gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me zinxhirin e saj të vlerës është i disponueshëm, ajo duhet:

a) të shpjegojë përpjekjet e bëra për të siguruar informacionin e nevojshëm në lidhje me zinxhirin e vlerës;

b) të shpjegojë arsyet pse nuk është siguruar i gjithë informacioni i nevojshëm;

c) të përshkruajë planet e saj për të siguruar këtë informacion në të ardhmen.

6. Pas përfundimit të periudhës 3-vjeçare të tranzicionit, të përmendur në pikën 5 të këtij neni,

njësia ekonomike mëmë duhet të përmbushë detyrimin për të raportuar informacionin e zinxhirit të vlerës, duke përdorur informacion të marrë drejtpërdrejt nga njësitë ekonomike, brenda zinxhirit të saj të vlerës ose, sipas rastit, vlerësime të këtij informacioni.

7. Kur është e zbatueshme, informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 të nenit 20/1 të këtij ligji, duhet të përfshijë gjithashtu referenca dhe shpjegime shtesë në lidhje me informacion tjetër, të përfshirë në raportin e konsoliduar të ecursisë së veprimtarisë dhe me vlerat e raportuara në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Neni 20/3

Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë

1. Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë përcaktojnë formatin, përmbajtjen, treguesit kryesorë dhe elementet e tjera të nevojshme për përgatitjen dhe publikimin e raporteve të qëndrueshmërisë, duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit ndërkombëtare dhe rajonale në këtë fushë.

2. Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë duhet të sigurojnë cilësinë e informacionit të raportuar, duke kërkuar që ai të jetë i kuptueshëm, i rëndësishëm, i verifikueshëm, i krahasueshëm dhe i paraqitur në mënyrë të besueshme.

Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë nuk duhet të vendosin një barrë të tepruar administrative ose financiare për njësitë ekonomike dhe duhet të marrin në konsideratë, në masën më të madhe të mundshme, nismat dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushën e raportimit të qëndrueshmërisë. Ato duhet gjithashtu të sigurojnë, në masën më të madhe të mundshme, koherencë me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin tjetër të zbatueshëm.

Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë duhet, në masën më të madhe të mundshme, t'i japin përparësi zbulimit të informacionit sasior, duke marrë parasysh barrën për njësitë ekonomike dhe nevojat e përdoruesve të informacionit të qëndrueshmërisë.

Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, duke marrë parasysh objektin e një standardi të veçantë, specifikojnë informacionin që njësitë ekonomike duhet të deklarojnë në lidhje me:

a) faktorët mjedisorë, përfshirë:



- i. zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë emetimet e gazeve serrë;
- ii. përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- iii. burimet ujore dhe detare;
- iv. përdorimin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese;
- v. ndotjen;
- vi. biodiversitetin dhe ekosistemet.

b) faktorët socialë dhe të drejtat e njeriut, përfshirë:

i. trajtimin dhe mundësitë e barabarta për të gjithë, duke përfshirë barazinë gjinore dhe pagën e barabartë për punë, me vlerë të barabartë, trajnimin dhe zhvillimin e aftësive, punësimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, masat për parandalimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës e diversitetin;

ii. kushtet e punës, duke përfshirë punësimin e sigurt, kohën e punës, pagat e përshtatshme, dialogun social, lirinë e krijimit të shoqatave, ekzistencën e këshillave të punës, negociatat kolektive, përfshirë përqindjen e punëtorëve të mbuluar nga marrëveshjet kolektive, të drejtat e informimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes së punëtorëve, ekuilibrin punë-jetë dhe shëndetin e sigurinë;

iii. respektimin e të drejtave të njeriut, liritë themelore, parimet dhe standardet demokratike të përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë Kartën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Deklaratën e Popujve Indigjenë, deklaratat dhe konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kartën Sociale Evropiane dhe Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

c) faktorët e qeverisjes, përfshirë:

i. rolin e organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike në lidhje me çështjet e qëndrueshmërisë dhe përbërjen e tyre, si dhe ekspertizën dhe aftësitë e tyre ose aksesin në to;

ii. veçoritë kryesore të sistemeve të kontrollit të brendshëm e të menaxhimit të riskut të njësisë ekonomike, në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë dhe procesin e vendimmarrjes;

iii. etikën e biznesit dhe kulturën e korporatës, përfshirë politikat kundër korrupsionit dhe ryshfetit, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe mirëqenien e kafshëve;

iv. aktivitetet dhe angazhimet e njësisë ekonomike në ushtrimin e ndikimit të saj politik, përfshirë aktivitetet lobuese;

v. menaxhimin dhe cilësinë e marrëdhënieve me klientët, furnizuesit dhe komunitetet e prekura nga aktivitetet e njësisë ekonomike, përfshirë praktikatat e pagesave dhe pagesat e vonuara për njësitë ekonomike të vogla e të mesme.

3. Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë specifikojnë informacionin perspektiv, retrospektiv, cilësor dhe sasior, sipas rastit, që duhet të raportohet nga njësitë ekonomike.

Neni 20/4

Dhënia e sigurisë për raportin e qëndrueshmërisë

1. Raporti i qëndrueshmërisë dhe raporti i qëndrueshmërisë i konsoliduar i nënshtrohen një angazhimi të dhënies së sigurisë për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat e këtij ligji dhe me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë.

2. Procedurat, standardet dhe niveli i kërkuar i dhënies së sigurisë përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për auditimin ligjor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

3. Opinioni i dhënies së sigurisë për raportin e qëndrueshmërisë dhe raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë përgatitet duke respektuar kufizimet e parashikuara nga ky ligj, në lidhje me raportimin e informacionit për zinxhirin e vlerës, në veçanti detyrimin që njësitë ekonomike të mos kërkojnë nga njësitë e tjera ekonomike që nuk tejkalojnë pragjet e përcaktuara në këtë ligj informacion që shkon përtej kërkesave të standardeve vullnetare të raportimit të qëndrueshmërisë, përveç informacionit shtesë që zakonisht shkëmbehet në sektorin përkatës.

4. Opinioni i dhënies së sigurisë përgatitet duke marrë parasysh edhe rastet e jashtëzakonshme kur njësitë ekonomike në zinxhirin e vlerës mund të mos jenë në gjendje të japin informacion, për shkak se dhënia e këtij informacioni nga një njësi e themeluar në një juridiksion tjetër do ta ekspozonte atë ndaj sanksioneve ose pasojave të tjera ligjore, sipas legjislacionit në fuqi të atij juridiksioni, vetëm për shkak të transmetimit të të dhënave të qëndrueshmërisë.



Neni 20/5

**Detyrimi i njësive ekonomike vendase (bija)
për publikim të raportit të qëndrueshmërisë, të
hartuar nga njësitet ekonomike të huaja
(mëma)**

1. Njësitet ekonomike të kontrolluara, të themeluara në territorin e Republikës së Shqipërisë, njësia mëmë përfundimtare e të cilave është e rregulluar nga legjislacioni i një juridiksionit tjetër, janë të detyruara të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm një raport të qëndrueshmërisë që mbulon informacionin e kërkuar, sipas shkronjës “a”, nënndarjet “iii” deri në “v”, shkronjave “b” deri në “dh” dhe, sipas rastit, shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 20/1 të këtij ligji, në nivelin e grupit të njësive mëmë në nivelin më të lartë.

Ky detyrim zbatohet vetëm për njësitet ekonomike të kontrolluara, të cilat në datën e raportimit kanë realizuar të ardhura të shfrytëzimit mbi 20 miliardë lekë në periudhën raportuese paraardhëse.

2. Degët e njësive ekonomike të themeluara në një juridiksion tjetër, të cilat nuk janë pjesë e një grupi ose zotërohen nga një njësi mëmë e themeluar në një juridiksion tjetër, janë të detyruara të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm një raport të qëndrueshmërisë që mbulon informacionin e kërkuar, sipas shkronjës “a”, nënndarjet “iii” deri në “v”, shkronjave “b” deri në “dh” dhe, sipas rastit, shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 20/1 të këtij ligji, në nivelin e grupit të njësive mëmë ose, nëse kjo nuk është e zbatueshme, në nivelin individual të njësive ekonomike të juridiksionit tjetër.

Ky detyrim zbatohet vetëm për degët e njësive ekonomike të themeluara në një juridiksion tjetër, kur njësia e vendit tjetër nuk ka një njësi të kontrolluar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vetëm në rastet kur dega ka realizuar të ardhura të shfrytëzimit më shumë se 20 miliardë lekë në periudhën raportuese paraardhëse.

3. Detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen vetëm kur njësia mëmë e juridiksionit tjetër, në nivel grupi ose, nëse kjo nuk është e zbatueshme, në nivel individual, ka realizuar të ardhura të shfrytëzimit më shumë se 45 miliardë lekë për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme.

4. Raporti i qëndrueshmërisë i njësive ekonomike të kontrolluara ose degëve të përmendura në pikat 1

dhe 2 të këtij neni hartohet në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë për njësitet ekonomike të juridiksionit tjetër të miratuara.

5. Përfundimisht nga sa parashikohet në pikën 4 të këtij neni, raporti i qëndrueshmërisë mund të hartohet në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të miratuara sipas nenit 20/3 të këtij ligji, ose në mënyrë të barasvlershme me këto standarde, kur kjo përcaktohet në përputhje me aktet nënligjore për barasvlershmërinë e standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë.

6. Kur informacioni i kërkuar për hartimin e raportit të qëndrueshmërisë nuk është i disponueshëm, njësia e kontrolluar ose dega i kërkon njësive mëmë të juridiksionit tjetër informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrimit.

Nëse njësia mëmë nuk vë në dispozicion informacionin e nevojshëm, njësia e kontrolluar ose dega harton, publikon dhe bën të aksesueshëm raportin e qëndrueshmërisë mbi bazën e informacionit që zotëron, ka përfutur ose siguruar, duke e shoqëruar me një deklaratë se informacioni i kërkuar nuk është vënë në dispozicion nga njësia mëmë.

7. Raporti i qëndrueshmërisë, i përmendur në këtë nen, publikohet i shoqëruar nga një opinion për dhënien e sigurisë, i përgatitur nga një ose më shumë persona ose shoqëri të autorizuar për dhënien e opinionit të sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, sipas legjislacionit të zbatueshëm të juridiksionit tjetër ose sipas legjislacionit shqiptar.

Nëse njësia mëmë e juridiksionit tjetër nuk siguron opinionin e dhënies së sigurisë, njësia e kontrolluar ose dega publikon raportin e qëndrueshmërisë, të shoqëruar me një deklaratë se njësia mëmë nuk ka vënë në dispozicion opinionin e nevojshëm të dhënies së sigurisë.

Neni 20/6

**Përgjegjësia për raportet e qëndrueshmërisë
së njësive ekonomike të vendeve të tjera**

1. Degët e njësive ekonomike të themeluara në një vend tjetër, të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë përgjegjëse për të garantuar, sipas dënjës dhe kapacitetit të tyre maksimal, që raporti i qëndrueshmërisë të hartohet në përputhje me nenin 20/5 dhe të publikohet e të



bëhet i aksesueshëm në përputhje me nenin 20/7 të këtij ligji.

2. Anëtarët e organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësive ekonomike të kontrolluara, të parashikuara në nenin 20/5, kanë përgjegjësi solidare për të garantuar, sipas dënjisë dhe kapacitetit të tyre maksimal, që raporti i qëndrueshmërisë të hartohet në përputhje me nenin 20/5 dhe të publikohet e të bëhet i aksesueshëm në përputhje me nenin 20/7 të këtij ligji.

Neni 20/7

Publikimi i raporteve të qëndrueshmërisë së njësive ekonomike të vendeve të tjera

1. Njësitë ekonomike të kontrolluara dhe degët e përmendura në nenin 20/6 të këtij ligji publikojnë raportin e qëndrueshmërisë, së bashku me opinionin e dhënies së sigurisë dhe, sipas rastit, me pasqyrat financiare të parashikuara në këtë ligj, në përputhje me sa parashikohet në pikën 1 të nenit 22 të këtij ligji.

2. Raporti i qëndrueshmërisë, opinionin e dhënies së sigurisë dhe, sipas rastit, pasqyrat financiare depozitohen pranë regjistrarit tregtar, ku është regjistruar njësia ekonomike e kontrolluar ose dega, dhe publikohen në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të pranuar, sipas legjislacionit vendas.

3. Kur raporti i qëndrueshmërisë, opinionin e dhënies së sigurisë dhe, sipas rastit, pasqyrat financiare nuk bëhen të aksesueshme për publikun nëpërmjet regjistrarit tregtar, ato bëhen të aksesueshme për publikun falas në faqen e internetit të njësive ekonomike të kontrolluar ose të degës, sipas kërkesave të pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji.”

Neni 18

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në paragrafin e dytë fjalët “legjislacioni në fuqi” zëvendësohen me fjalët “legjislacioni i fushës përkatëse në fuqi”;

b) Pas paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Njësi ekonomike aktive në shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve primare konsiderohen njësitë që ushtrojnë veprimtari në prerjen dhe shfrytëzimin e pyjeve primare, sipas përcaktimeve të

legjislacionit dhe kategorizimeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë.”.

2. Në pikën 2 fjalët “të ardhurat e veprimtaria” zëvendësohen me fjalët “të ardhurat e shfrytëzimit”.

3. Në pikën 3 togfjalëshi “13,5 milionë lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “10 000 000 lekë”.

4. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën “a” fjalët “institucioneve shtetërore” zëvendësohen me fjalët “secilit prej institucioneve shtetërore veçmas”.

b) nëndarja “ii” e shkronjës “b” ndryshohet si më poshtë:

“tatimet e vendosura mbi të ardhurat ose fitimet duke përjashtuar tatimet mbi konsumin, të tilla si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akcizat dhe tatimet e tjera që ngarkohen mbi shitjet ose transaksionet tregtare.”.

5. Pas shkronjës “b” të pikës 4 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) kur pagesat i atribuohen një projekti specifik, raporti tregon shumën totale për secilën lloj pagese të parashikuar në këtë pikë, si dhe shumën totale të pagesave për secilin projekt. Kur pagesat burojnë nga detyrime të përcaktuara në nivel njësie, ato mund të deklarohen në nivel njësie dhe jo në nivel projekti.

Deklarimi i pagesave, sipas kësaj pike, bazohet në përmbajtjen dhe jo në formën e pagesës ose aktivitetit dhe pagesat apo aktivitetet nuk mund të ndahen ose të bashkohen artificialisht për të shmangur zbatimin e këtij neni.”.

6. Në pikën 7 fjalët “raportin e konsoliduar” zëvendësohen me fjalët “raportin e konsoliduar të pagesave”.

Neni 19

Në nenin 22 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Njësitë ekonomike brenda afatit të përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës, ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, shoqëruar, sipas rastit, me raportet e tjera, sipas përcaktimeve në nenet 17 deri 21 të këtij ligji, si dhe raportin e auditimit ose raportet e tjera të dhënies së sigurisë, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit të fushës përkatëse në fuqi.”.



2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Njësitet ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik duhet të publikojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit ose raportet e tjera të dhënies së sigurisë, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme edhe në faqet e tyre zyrtare të internetit, brenda afatit të përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.”.

3. Në pikën 3 fjalët “nëse shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare tejkalon” zëvendësohen me fjalët “nëse njëkohësisht shifra e aktivitetit dhe shifra e të ardhurave në pasqyrat financiare për 2 vjet radhazi tejkalojnë”.

4. Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“4. Një kategori mikronjësish mund të përjashtohet nga detyrimi për publikimin e pasqyrave financiare, sipas përcaktimeve të parashikuara me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për financat.

5. Kur pasqyrat financiare vjetore dhe raporti i ecurisë së veprimtarisë publikohen në formën e tyre të plotë, ato duhet të jenë në përputhje të plotë me strukturën dhe formulimin në të cilat është bazuar audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit për dhënien e opinionit të auditimit apo dhënien e sigurisë. Publikimi i tyre shoqërohet me raportin e auditimit ose raportin e dhënies së sigurisë.

6. Për rastet kur standardet kontabël të raportimit financiar të zbatueshme parashikojnë një format të reduktuar të pasqyrave financiare, formati i reduktuar që publikohet duhet të përmbajë detyrimisht:

a) një deklaram të qartë se formati i publikuar është i reduktuar;

b) informacion për autoritetin ku janë depozituar pasqyrat financiare të plota ose, kur ato nuk janë depozituar ende, një deklaram për këtë fakt;

c) informacion nëse audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit ka dhënë opinion të pamodifikuar (pa rezervë), opinion të modifikuar (me rezervë), opinion negativ ose nëse nuk ka qenë në gjendje të japë opinion auditimi;

ç) informacion nëse raporti i auditimit ka përfshirë theksim të ndonjë çështjeje, pa e konsideruar atë si rezervë në opinionin e auditimit;

d) informacion nëse raportet e tjera të dhënies së sigurisë së audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit

përmbajnë gjetje në lidhje me përputhshmërinë e tyre me kërkesat e këtij ligji.”.

Neni 20

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Formati elektronik i raportimit

1. Njësitet ekonomike, subjekt i kërkesave të nenit 18/1 të këtij ligji, përgatitin raportin e ecurisë së veprimtarisë në format elektronik raportimi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm të Bashkimit Evropian dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Njësitet ekonomike të parashikuara në pikën 1 të këtij neni paraqesin raportin e qëndrueshmërisë, duke përfshirë, sipas rastit, edhe informacionin e kërkuar nga legjislacioni përkatës i Bashkimit Evropian për taksonominë, në përputhje me formatin elektronik të raportimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Njësitet ekonomike mëmë, subjekt i kërkesave të nenit 20/1 të këtij ligji, përgatisin raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë në format elektronik raportimi në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm të Bashkimit Evropian dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Njësitet ekonomike mëmë të parashikuara në pikën 3 të këtij neni paraqesin raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë, duke përfshirë, sipas rastit, edhe informacionin e kërkuar nga legjislacioni përkatës i Bashkimit Evropian për taksonominë, në përputhje me formatin elektronik të raportimit, sipas pikës 3 të këtij neni.”.

Neni 21

Në nenin 23 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2 fjala “çliron” zëvendësohet me fjalën “përjashton”.

2. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare përgatit një deklaratë pajtueshmërie, e cila publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore. Forma dhe përmbajtja e deklaratës së

pajtueshmërisë miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, me propozim të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.”.

Neni 22

Pas kreut III shtohet kreu III/1 me këtë përmbajtje:

“KREU III/1
RAPORTI PËR INFORMACIONIN E
TATIMIT MBI TË ARDHURAT

Neni 23/1

**Njësitë ekonomike dhe degët, të cilat
raportojnë për informacionin e tatimit mbi të
ardhurat**

1. Njësitë ekonomike mëmë të nivelit më të lartë, të rregulluara nga legjislacioni shqiptar, të cilat në datën e raportimit kanë realizuar të ardhura të konsoliduara që tejkalojnë shumën 75 000 000 000 lekë për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme, sipas pasqyrave financiare të konsoliduara, janë të detyruara të hartojnë, të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm një raport për informacionin e tatimit mbi të ardhurat për vitin e fundit nga këta 2 vjet financiarë.

Detyrimi i mësipërm pushon së zbatuari kur të ardhurat e konsoliduara të njësisë mëmë në nivelin më të lartë në datën e raportimit bien nën shumën prej 75 000 000 000 lekësh për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme.

2. Njësitë ekonomike që nuk janë pjesë e një grupi, të rregulluara nga legjislacioni shqiptar, të cilat në datën e raportimit kanë realizuar të ardhura që tejkalojnë shumën 75 000 000 000 lekë për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme, sipas pasqyrave financiare vjetore, janë të detyruara të hartojnë, të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm një raport për informacionin e tatimit mbi të ardhurat për vitin e fundit nga këta 2 vjet financiarë.

Detyrimi i mësipërm pushon së zbatuari kur të ardhurat totale të njësisë ekonomike që nuk është pjesë e një grupi në datën e raportimit bien nën shumën prej 75 000 000 000 lekësh për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme.

3. Dispozitat në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për njësitë ekonomike që nuk janë pjesë e

një grupi ose për njësitë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë dhe njësitë e tyre, pjesë të grupit, kur këto njësi, përfshirë degët e tyre, janë themeluar ose ushtrojnë veprimtarinë e tyre të përhershme ekonomike vetëm brenda territorit të një shteti të vetëm dhe në asnjë juridiksion tjetër tatimor.

4. Dispozitat në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për njësitë ekonomike që nuk janë pjesë e një grupi dhe njësitë mëmë në nivelin më të lartë, kur këto njësi ose njësitë, pjesë e grupit, janë të detyruara të publikojnë raport, sipas legjislacionit të posaçëm, që rregullon institucionet financiare dhe përmban informacion për të gjitha veprimtaritë e tyre.

5. Njësitë ekonomike të kontrolluara, të mesme dhe të mëdha, të rregulluara nga legjislacioni shqiptar, të cilat kontrollohen nga një njësi ekonomike mëmë në nivelin më të lartë, që nuk rregullohet nga legjislacioni shqiptar, kur të ardhurat e konsoliduara në nivel grupi tejkalojnë shumën 75 000 000 000 lekë për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme, janë të detyruara të hartojnë, të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm raportin për informacionin e tatimit mbi të ardhurat për atë njësi ekonomike mëmë në nivelin më të lartë për vitin e fundit nga këta 2 vjet financiarë të njëpasnjëshëm.

Kur raporti nuk është i disponueshëm, njësia e kontrolluar kërkon informacionin e nevojshëm nga njësia mëmë në nivelin më të lartë. Nëse ky informacion nuk vihet në dispozicion, njësia e kontrolluar harton, publikon dhe bën të aksesueshëm raportin me të gjithë informacionin që zotëron, ka përfutur ose ka siguruar, duke e shoqëruar atë me një deklaratë, ku tregohet se njësia mëmë nuk ka vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm.

Detyrimi pushon së zbatuari kur të ardhurat e konsoliduara të njësisë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë janë nën shumën prej 75 000 000 000 lekësh për secilën nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme.

6. Degët e njësisë ekonomike, që nuk rregullohen nga legjislacioni shqiptar, të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të hartojnë, të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm raportin për informacionin e tatimit mbi të ardhurat, në lidhje me njësinë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë ose njësinë ekonomike që nuk është pjesë e një grupi, për vitin e fundit nga dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme, kur këto njësi



ekonomike kanë të ardhura mbi 75 000 000 000 lekë për secilën nga dy periudhat raportuese të njëpasnjëshme.

Kur raporti nuk është i disponueshëm, personat e autorizuar kërkojnë nga njësia mëmë ose nga njësia ekonomike që nuk është pjesë e një grupi informacionin e nevojshëm. Nëse informacioni nuk vihet në dispozicion, dega harton, publikon dhe bën të aksesueshëm raportin me të gjithë informacionin që zotëron, që ka përfutur ose ka siguruar, duke e shoqëruar atë me një deklaratë ku tregohet se njësia mëmë ose njësia që nuk është pjesë e një grupi nuk ka vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm.

Ky detyrim zbatohet vetëm për degët që kanë realizuar të ardhura mbi pragun e përcaktuar në nën pikën 1.2 të nenit 4 të këtij ligji për secilën nga dy periudhat raportuese të njëpasnjëshme dhe pushon së zbatuari kur të ardhurat e degës janë nën këtë prag për dy periudha raportuese të njëpasnjëshme.

Përcaktimet e këtij neni zbatohen për degët vetëm kur plotësohen njëkohësisht këto kritere:

a) njësia ekonomike që ka krijuar degën është ose një njësi pjesë e një grupi, njësia ekonomike mëmë në nivelin më të lartë të të cilit nuk rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe të ardhurat e konsoliduara të të cilit kanë tejkaluar shumën 75 000 000 000 lekë për secilën nga dy periudhat raportuese të njëpasnjëshme, siç reflektohet në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose një njësi ekonomike të ardhurat e së cilës kanë tejkaluar shumën 75 000 000 000 lekë për secilën nga dy periudhat raportuese të njëpasnjëshme, siç reflektohet në pasqyrat e saj financiare;

b) njësia ekonomike mëmë në nivelin më të lartë, e përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, nuk ka njësi ekonomike të kontrolluara të mesme ose të mëdha, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Degët nuk u nënshtrohen më detyrimeve të raportimit të këtij neni kur kriteri i përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike nuk përmbushet për dy periudhat raportuese të njëpasnjëshme.

7. Dispozitat e pikave 5 dhe 6 të këtij neni nuk zbatohen kur raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat publikohet nga njësia ekonomike mëmë në nivelin më të lartë ose nga njësia ekonomike që nuk është pjesë e një grupi, në përputhje me kërkesat e këtij ligji për përmbajtjen e raportit, dhe kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) raporti bëhet i aksesueshëm publikisht, falas, në një format elektronik të lexueshëm nga pajisjet, në faqen e internetit të njësisë ekonomike mëmë ose të njësisë ekonomike që nuk është pjesë e një grupi, jo më vonë se 12 muaj nga data e raportimit të periudhës për të cilën është hartuar raporti;

b) raporti publikohet në gjuhën shqipe dhe të paktën në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian;

c) raporti identifikon emrin dhe selinë e një njësie të vetme të kontrolluar ose emrin dhe adresën e një dege të vetme, të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila ka publikuar raportin, në përputhje me këtë ligj.

8. Njësitë ekonomike të kontrolluara ose degët që nuk janë subjekt i dispozitave të pikave 5 dhe 6 të këtij neni janë të detyruara të publikojnë dhe të bëjnë të aksesueshëm raportin për informacionin e tatimit mbi të ardhurat, kur qëllimi i vetëm i krijimit të tyre është shmangia e detyrimeve të raportimit, të përcaktuara në këtë kre.

9. Raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat, i parashikuar në këtë kapitull, është një detyrim publik shtesë dhe nuk zëvendëson, as nuk përjashton, detyrimet e raportimit, të përcaktuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Neni 23/2

Përmbajtja e raportit për informacionin e tatimit mbi të ardhurat

1. Raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat, i kërkuar në zbatim të nenit paraardhës, përfshin informacion në lidhje me të gjitha veprimtaritë e njësisë ekonomike që nuk është pjesë e një grupi ose të njësisë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë, duke përfshirë ato të të gjitha njësive, pjesë të grupit, të konsoliduara në pasqyrat financiare për vitin financiar përkatës.

2. Informacioni i raportit përmban:

a) emrin e njësisë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë ose të njësisë ekonomike që nuk është pjesë e një grupi, vitin financiar, monedhën e përdorur për paraqitjen e raportit dhe, sipas rastit, një listë të të gjitha njësive të kontrolluara, të konsoliduara në pasqyrat financiare të njësisë mëmë në nivelin më të lartë, për vitin financiar përkatës, të themeluara në Republikën e Shqipërisë ose në juridiksione tatimore të klasifikuara si



jobashkëpunuese, sipas listave ndërkombëtare të pranuara;

b) përshkrim të shkurtër të natyrës së veprimtarive të tyre;

c) numrin e punonjësve, referuar kohës normale të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit vendas të fushës;

ç) të ardhurat, të cilat llogariten si:

i. shuma e të ardhurave të shfrytëzimit, të ardhurave të tjera të shfrytëzimit, të ardhurave nga interesat në pjesëmarrje, përjashtuar dividendët e marrë nga njësitë që bëjnë pjesë në grup, të ardhurat nga investime të tjera dhe huat, paraqitur në aktivet afatgjata, interesat e tjera të arkëtueshme dhe të ardhura të ngjashme; ose

ii. të ardhura, sipas përcaktimeve të kuadrit të raportimit financiar, mbi bazën e të cilit përgatiten pasqyrat financiare, duke përjashtuar rregullimet e vlerës dhe dividendët e marrë nga njësitë që janë pjesë e grupit.

d) shumën e fitimeve ose humbjeve përpara tatimit mbi të ardhurat;

dh) shumën e tatimit mbi të ardhurat të njohur gjatë vitit financiar përkatës, e cila llogaritet si tatimi aktual mbi fitimet ose humbjet e tatueshme të vitit financiar nga njësitë ekonomike dhe degët në juridiksionin tatimor përkatës;

e) shumën e tatimit mbi të ardhurat, të paguar në mjete monetare, e cila llogaritet si shuma e tatimit mbi të ardhurat të paguar gjatë vitit financiar përkatës nga njësitë ekonomike dhe degët në juridiksionin tatimor përkatës;

ë) shumën e fitimeve të akumuluar në fund të vitit financiar përkatës.

Për qëllimet e shkronjës “ç”, të ardhurat përfshijnë edhe transaksionet me palët e lidhura.

Për qëllimet e shkronjës “dh” tatimfitimi aktual lidhet vetëm me veprimtaritë e një njësie ekonomike në vitin financiar përkatës dhe nuk përfshin tatimet e shtyra apo provizionet për detyrime tatimore të pasigurta.

Për qëllimet e shkronjës “e” tatimet e paguara përfshijnë edhe tatimet në burim të paguara nga njësitë e tjera në lidhje me pagesat për njësitë dhe degët brenda një grupi.

Për qëllimet e shkronjës “ë” fitimet e akumuluar nënkuptojnë shumën e fitimeve nga vitet e mëparshme financiare dhe nga viti financiar përkatës, shpërndarja e të cilave nuk është vendosur

ende. Për degët, të ardhurat e akumuluar janë ato të njësisë ekonomike që ka hapur degën.

3. Informacioni i përmendur në pikën 2 të këtij neni paraqitet në përputhje me udhëzimet dhe modelet e raportimit, të përcaktuara me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për financat, propozuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, duke përdorur një model të përbashkët dhe formate elektronike raportimi të lexueshme nga pajisjet.

4. Raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat paraqet informacionin e përcaktuar në këtë nen, veçmas për çdo shtet dhe juridiksion tatimor ku njësia ekonomike operon. Për juridiksionet tatimore të klasifikuara si jobashkëpunuese sipas listave ndërkombëtare të pranuara, si dhe për juridiksionet e identifikuara si në rrezik për qëllime tatimore, informacioni paraqitet gjithmonë veçmas. Për juridiksionet e tjera tatimore informacioni paraqitet në mënyrë të agreguar. Informacioni i atribuohet juridiksionit tatimor përkatës mbi bazën e themelimit, ekzistencës së një selie fikse biznesi ose veprimtarie të përhershme ekonomike që mund t'i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat në atë juridiksion. Kur disa njësi, pjesë të një grupi, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat në të njëjtin juridiksion tatimor, informacioni paraqitet si shumë e përbashkët. Një veprimtari e caktuar nuk mund t'i atribuohet më shumë se një juridiksioni tatimor.

5. Njësitë ekonomike mund të përjashtojnë përkohësisht nga raporti disa elemente të informacionit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, vetëm kur publikimi i tyre do të cenonte në mënyrë të konsiderueshme pozicionin tregtar. Çdo përjashtim duhet të cilësohet qartë në raport dhe të shoqërohet me shpjegim të argumentuar. Informacioni i përjashtuar publikohet brenda një periudhe jo më të gjatë se 5 vjet nga data e përjashtimit. Përjashtimi nuk lejohet për informacionin që lidhet me juridiksionet tatimore të listuara si jobashkëpunuese, sipas listave ndërkombëtare të pranuara.

6. Raporti mund të përfshijë, sipas rastit, në nivel grupi një shpjegim të përgjithshëm mbi çdo mosrakordim material ndërmjet shumave të deklaruara për tatimin e njohur (shkronja “dh” e pikës 2) dhe tatimin e paguar (shkronja “e” e pikës 2), duke marrë në konsideratë edhe shumat për vitet e mëparshme.

7. Monedha e përdorur në raport është monedha në të cilën përgatiten pasqyrat financiare të



konsoliduara të njësisë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë ose pasqyrat financiare të njësisë që nuk është pjesë e një grupi. Për rastet e degëve të përmendura në nenin përkatës të këtij ligji monedha raportuese është ajo e pasqyrave financiare të degës.

Për qëllime të zbatimit të pragjeve të raportimit të përcaktuara në këtë ligj, kur pasqyrat financiare përgatiten në një monedhë tjetër nga monedha raportuese, pragjet përkatëse konvertohen në monedhën raportuese të vendit tjetër sipas kursit të këmbimit të zbatueshëm në përputhje me kuadrin përkatës të raportimit. Asnjë ndërmarrje, degë apo subjekt raportues nuk mund të detyrohet ta publikojë raportin në një monedhë tjetër nga ajo e përcaktuar sipas këtij neni.

8. Në raport cilësohet qartë nëse ai është përgatitur në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

Neni 23/3

Publikimi dhe aksesueshmëria e raportit për informacionin e tatimit mbi të ardhurat

1. Raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat dhe, sipas rastit, pasqyrat financiare të parashikuara në nenin 23/1 të këtij ligji publikohen dhe depozitohen pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar brenda 12 muajve nga data e raportimit të periudhës për të cilin janë përgatitur.

2. Raporti dhe pasqyrat financiare bëhen të aksesueshme për publikun falas në gjuhën shqipe dhe të paktën në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, në faqen e internetit të njësisë ekonomike ose të degës përkatëse.

3. Përjashtimisht, detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohet kur raporti dhe pasqyrat financiare janë të aksesueshme publikisht dhe falas në faqen elektronike të autoritetit përkatës ku njësia ekonomike është e regjistruar.

Neni 23/4

Përgjegjësia për hartimin dhe publikimin e raportit për informacionin e tatimit mbi të ardhurat

1. Anëtarët e organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike mëmë në nivelin më të lartë ose të njësisë ekonomike që nuk janë pjesë të grupit, të përmendura në nenin 23/1 të këtij ligji, duke vepruar brenda kompetencave të tyre, sipas legjislacionit shqiptar, kanë përgjegjësi solidare

për të garantuar që raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat të hartohet, të publikohet dhe të bëhet i aksesueshëm, në përputhje me nenet 23/1, 23/2 dhe 23/3 të këtij ligji.

2. Anëtarët e organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike të kontrolluara, të përmendura në pikën 5 të nenit 23/1 të këtij ligji, si dhe personat e autorizuar për formalitetet e deklarimit të degëve, të përmendura në pikën 6 të nenit 23/1 të këtij ligji, kanë përgjegjësi solidare, sipas dijenisë dhe kapaciteteve të tyre maksimale, që raporti për informacionin e tatimit mbi të ardhurat të hartohet në përputhje me nenet 23/1 dhe 23/2 të këtij ligji dhe të publikohet e të bëhet i aksesueshëm në përputhje me nenin 23/3 të këtij ligji.”

Neni 23

Në pikën 2 të nenit 24 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) fjalët “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” zëvendësohen me fjalët “standardet kontabël ndërkombëtare të raportimit financiar”;

b) fjalët “standardeve ndërkombëtare” zëvendësohen me fjalët “standardeve kontabël ndërkombëtare”;

c) fjalët “e ka autoritetin” zëvendësohen me fjalët “i rekomandon ministrit përgjegjës për financat”.

2. Fjalja e parë e shkronjës “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit standardet kombëtare të kontabilitetit dhe përkthimin në gjuhën shqipe të standardeve kontabël ndërkombëtare të raportimit financiar dhe standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë, të detyrueshme apo vullnetare për zbatim.”.

3. Në shkronjën “f” fjalët “dhe raportimit financiar” zëvendësohen me fjalët “raportimit financiar dhe raportimit të qëndrueshmërisë”.

4. Shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) të organizojë tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt nga njësitë ekonomike të SKK-ve/SNRF-ve dhe standardeve të qëndrueshmërisë.”.



Neni 24

Në nenin 25 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2 fjalët “mandatohen me urdhër” zëvendësohen me fjalët “mandatohen dhe lirohen me urdhër”.

2. Në pikën 4 pas fjalëve “dhe/ose financës” shtohen fjalët “dhe/ose raportimin e qëndrueshmërisë”.

Neni 25

Në pikën 2 të nenit 27 fjalët “pasqyrave financiare” zëvendësohen me fjalët “pasqyrave financiare dhe raportit të qëndrueshmërisë”.

Neni 26

Pas pikës 3 të nenit 31 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Kërkesat për raportimin e qëndrueshmërisë, raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë dhe raportin për informacionin mbi tatimin mbi të ardhurat zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat raportuese që fillojnë nga viti 2028 e në vijim. Njësitë ekonomike të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji hartojnë dhe publikojnë raportin jofinanciar për periudhat raportuese përfshirë atë të vitit 2027, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Nga periudha raportuese e vitit 2028 e në vijim raportimi jofinanciar shfuqizohet dhe zëvendësohet nga raportimi i qëndrueshmërisë. Njësitë

ekonomike mund të zbatojnë raportimin e qëndrueshmërisë mbi baza vullnetare, duke filluar nga periudha raportuese e vitit 2028 e në vijim.

5. Deri në miratimin e rregullimeve teknike përkatëse të raportimit elektronik dhe të taksonomisë, sipas legjislacionit të zbatueshëm të Bashkimit Evropian, njësitë ekonomike individuale dhe ato mëmë nuk kanë detyrimin të zbatojnë kërkesat e nenit 22/1 të këtij ligji. Rregullat e hollësishme dhe procedurat për formatin, paraqitjen, depozitimin dhe publikimin e informacionit të parashikuar në këtë nen miratohen me akt nënligjor nga ministri përgjegjës për financat, me propozim të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.”.

Neni 27

Aneksi 1 zëvendësohet me aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 470, datë 4.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

ANEKSI 1 (mijë lekë)

<i>Madhësia</i>	<i>2019-2021</i>	<i>2022-2024</i>	<i>2025-2027</i>	<i>2028</i>
Mikronjësi				
Aktivët	≤ 15 000	≤ 25 000	≤ 35 000	≤ 45 000
Të ardhurat e shfrytëzimit	≤ 30 000	≤ 50 000	≤ 70 000	≤ 90 000
Numri i punonjësve	≤ 10	≤ 10	≤ 10	≤ 10
Njësi ekonomike të vogla				
Aktivët	≤ 150 000	≤ 250 000	≤ 350 000	≤ 500 000
Të ardhurat e shfrytëzimit	≤ 300 000	≤ 500 000	≤ 700 000	≤ 1 000 000
Numri i punonjësve	≤ 50	≤ 50	≤ 50	≤ 50
Njësi ekonomike të mesme				
Aktivët	≤ 750 000	≤ 1 250 000	≤ 2 000 000	≤ 2 500 000



Të ardhurat e shfrytëzimit	$\leq 1\,500\,000$	$\leq 2\,500\,000$	$\leq 4\,000\,000$	$\leq 5\,000\,000$
Numri i punonjësve	≤ 250	≤ 250	≤ 250	≤ 250
Njësi ekonomike të mëdha				
Aktivitet	$\geq 750\,000$	$\geq 1\,250\,000$	$\geq 2\,000\,000$	$\geq 2\,500\,000$
Të ardhurat e shfrytëzimit	$\geq 1\,500\,000$	$\geq 2\,500\,000$	$\geq 4\,000\,000$	$\geq 5\,000\,000$
Numri i punonjësve	≥ 250	≥ 250	≥ 250	≥ 250
Grupe të vogla				
Aktivitet	$\leq 150\,000$	$\leq 250\,000$	$\leq 350\,000$	$\leq 500\,000$
Të ardhurat e shfrytëzimit	$\leq 300\,000$	$\leq 500\,000$	$\leq 700\,000$	$\leq 1\,000\,000$
Numri i punonjësve	≤ 50	≤ 50	≤ 50	≤ 50
Grupe të mesme				
Aktivitet	$\leq 750\,000$	$\leq 1\,250\,000$	$\leq 2\,000\,000$	$\leq 2\,500\,000$
Të ardhurat e shfrytëzimit	$\leq 1\,500\,000$	$\leq 2\,500\,000$	$\leq 4\,000\,000$	$\leq 5\,000\,000$
Numri i punonjësve	≤ 250	≤ 250	≤ 250	≤ 250
Grupe të mëdha				
Aktivitet	$\geq 750\,000$	$\geq 1\,250\,000$	$\geq 2\,000\,000$	$\geq 2\,500\,000$
Të ardhurat e shfrytëzimit	$\geq 1\,500\,000$	$\geq 2\,500\,000$	$\geq 4\,000\,000$	$\geq 5\,000\,000$
Numri i punonjësve	≥ 250	≥ 250	≥ 250	≥ 250

DEKRET
Nr. 470, datë 4.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 87/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare””.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 89/2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 173/2014,
“PËR DISIPLINËN NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 173/2014, “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 7

Autoritetet përgjegjëse

Autoritetet përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore ndaj ushtarakëve të Forcave të Armatosura janë, si më poshtë:

a) Presidenti i Republikës për dhënien e masës disiplinore shumë të rëndë “Shkarkim dhe lirim nga Forcat e Armatosura” për oficerët me grada madhore.

Propozimi për dhënien e kësaj mase disiplinore shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura bëhet nga Kryeministri, ndërsa për oficerët e tjerë me grada madhore bëhet nga ministri i Mbrojtjes;

b) Ministri i Mbrojtjes për dhënien e masave disiplinore shumë të rënda:

i. të parashikuara nga shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 14 për oficerët me grada madhore. Propozimi për dhënien e këtyre masave bëhet nga Komisioni i Lartë Disiplinor;

ii. për të gjithë oficerët e Forcave të Armatosura, me përjashtim të masave për të cilat autoriteti përgjegjës është Presidenti i Republikës, si dhe masave të parashikuara nga nënndarja “i” e kësaj shkronje. Propozimi për dhënien e kësaj mase bëhet nga Komisioni i Lartë Disiplinor;

c) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, për dhënien e:

i. masave disiplinore të rënda të parashikuara në shkronjat “a” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 14 për oficerët me grada madhore;

ii. masave disiplinore të lehta e të rënda për ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm e të strukturave me drejtues civilë të varësisë së tyre të drejtpërdrejtë;

iii. masave disiplinore të lehta e të rënda për ushtarakët që shërbejnë në shtabet e NATO-s, përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare;

iv. masave disiplinore të lehta e të rënda për drejtuesit ushtarakë të strukturave mbështetëse dhe strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

v. masave disiplinore shumë të rënda të përcaktuara në shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 3, të nenit 14 për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura. Propozimi për dhënien e kësaj mase bëhet nga Komisioni i Lartë Disiplinor;

ç) komandanti i forcës dhe strukturës mbështetëse për dhënien e masave disiplinore të mëposhtme:

i. masat disiplinore të lehta e të rënda për drejtuesit e strukturave të varësisë, me përjashtim të oficerëve me grada madhore;

ii. masat disiplinore të lehta e të rënda për ushtarakët në varësi të tyre;

iii. masat disiplinore shumë të rënda për nënoficerët dhe ushtarët e forcës dhe strukturës mbështetëse, me përjashtim të masave disiplinore për të cilat autoritet përgjegjës është shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Propozimi për dhënien e kësaj mase bëhet nga Komisioni i Lartë Disiplinor;

d) komandantët në nivel brigade, regjimenti, distrikti, batalioni, flotilje, njësie kryesore ose njësie bazë në institucionet arsimore për dhënien e masave disiplinore të mëposhtme:

i. masat disiplinore të lehta e të rënda për drejtuesit e strukturave të varësisë;

ii. masat disiplinore të lehta e të rënda për ushtarakët në varësi të tyre;

dh) komandantët në nivel kompanie ose toge për dhënien e masave disiplinore për ushtarakët në varësi të tyre.”.

Neni 2

Shkronja “e”, e pikës 1, të nenit 11 ndryshohet, si më poshtë:

“e) përdorimi dhe lejimi i lëvizjes së automjeteve të Forcave të Armatosura pa dokumentacionin përkatës.”.

Neni 3

Pas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 12 shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) dhënia e intervistave të paaautorizuara në mediat e shkruara dhe audiovizive, në kundërshtim me rregullat e miratuara për këtë qëllim;”.

Neni 4

Në shkronjën “e”, të nenit 13 fjalët “kur nuk përbën vepër penale” hiqen.



Neni 5

Pas shkronjës “dh”, të pikës 3, të nenit 14 shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) “Ndërprerja e studimeve”, e cila është masë ekstreme e dhënë për studentët dhe kursantët për shkelje disiplinore shumë të rënda.”.

Neni 6

Në nenin 16 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “me shkrim” hiqen.

2. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Njoftimi i personave që ndodhen në shërbim në Forcat e Armatosura bëhet nëpërmjet administratës së tyre.

1/2. Mënyrat dhe mjetet e njoftimit, në kuptim të këtij neni, janë si më poshtë:

- a) njoftimi me shkrim;
- b) njoftimi me postë;
- c) njoftimi me mjete elektronike.”.

Neni 7

Në pikën 1, të nenit 17 fjalët “me shkrim” zëvendësohen me fjalët “sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji”.

Neni 8

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Pushimi i procedimit disiplinor

1. Procedimi disiplinor ndërpritet në rast se gjatë hetimit disiplinor rezulton, se:

a) shkelja disiplinore e pretenduar nuk ka ndodhur;

b) veprimi apo mosveprimi i shqyrtuar nuk përbën shkelje disiplinore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

c) shkelja disiplinore nuk është kryer nga ushtaraku për të cilin ka filluar procedimi disiplinor;

ç) shkelja disiplinore është parashkruar;

d) për të njëjtën shkelje është dhënë një masë disiplinore.

2. Pushimi i procedimit disiplinor vendoset nga struktura përgjegjëse për hetimin disiplinor, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Në rastet kur procedimi disiplinor pushohet sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni, por gjatë hetimit rezulton se ka ndodhur një shkelje tjetër disiplinore që hetohet nga një strukturë tjetër, dokumentacioni dhe materialet e grumbulluara i përcillen strukturës kompetente.”.

Neni 9

Pas shkronjës “b”, të nenit 23 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) ushtarakët e Forcave të Armatosura ndaj të cilëve është marrë një masë disiplinore shumë e rëndë, sipas përcaktimeve të shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 3, të nenit 14 të këtij ligji, dhe që për një periudhë 2-vjeçare nuk kanë kryer asnjë shkelje tjetër disiplinore të rëndë.”.

Neni 10

Në nenin 25 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ankimi për masat disiplinore të rënda, të dhëna nga komandantët në nivel regjimenti, distrikti, batalioni, baze ajrore, bëhet tek eprori i drejtpërdrejtë i autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore.”.

3. Në pikën 8, togfjalëshi “10 ditëve” zëvendësohet me togfjalëshin “30 ditëve”.

4. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Autoriteti përgjegjës, tek i cili bëhet ankimi, merr vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për ankimin. Nëse gjatë procesit rezulton se nevojitet më shumë kohë për sigurimin e informacioneve apo verifikimin e rrethanave, autoriteti përgjegjës mund të vendosë shtyrjen e afatit edhe për 30 ditë të tjera, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative. Arsytet që kanë sjellë shtyrje të afatit duhet t’i njoftohen palës.”.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 480, datë 5.8.2026 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 480, datë 5.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 89/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 173/2014, “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 90/2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 82/2024,
“PËR POLICINË E SHTETIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 46 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Shërbimet e Policisë së Shtetit organizohen në departamente, drejtori qendrore dhe vendore, struktura të veçanta, struktura tekniko-shkencore, teknologjike dhe të informacionit, komisarate, sektorë, njësi dhe stacione policore, që e ushtrojnë veprimtarinë në nivel qendror dhe vendor sipas shpërndarjes territoriale, në varësi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit

garanton që këto shërbime të mbështeten me kapacitete njerëzore, financiare, administrative, operacionale dhe logjistike për ushtrimin e shërbimeve policore në secilin nivel organizativ.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Pika 4 shfuqizohet.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë:

“6. Numri i personelit të Policisë së Shtetit miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.”.

Neni 2

Në nenin 48, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Departamenti është strukturë administrativo-operacionale dhe organizohet në nivel qendror.”.

Neni 3

Në nenin 49 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtoria vendore është strukturë administrative dhe operacionale e Policisë së Shtetit në nivel vendor.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtoria vendore e policisë përbëhet nga komisarate, stacione dhe posta policore.”.

Neni 4

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50
Komisariati

Komisariati i policisë është strukturë bazë administrative, operacionale dhe hetimore në varësi të drejtorisë vendore dhe ushtron përgjegjësitë e policisë në territorin që ka në juridiksion.”.

Neni 5

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51
Stacioni i policisë dhe posta policore

Stacioni i policisë është njësi policore administrative, operacionale dhe hetimore në varësi të komisarit ose në raste të veçanta, kur nuk ka



komisariat, në varësi të drejtorisë vendore të policisë. Stacionet mund të jenë të përhershme ose të përkohshme. Në varësi të dinamikës së lëvizjeve demografike dhe sezoneve turistike ngrihet postë policore e përhershme ose e përkohshme.”

Neni 6

Në nenin 53, pika 1, togfjalëshi “sistemin e drejtësisë penale” zëvendësohet me togfjalëshin “sistemin e drejtësisë”.

Neni 7

Në nenin 56, pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit pas lirimit nga detyra rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit dhe i jepet grada “Drejtues i Parë” pa të drejtë riemërimi si drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Në interes të shërbimit të rendit dhe të sigurisë publike, ai mund të kryejë funksione drejtuese, këshillimore, pedagogjike ose të atashohet si oficer kontakti. Me përfundimin e qëndrimit në detyrë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit gëzon trajtim të veçantë, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 8

Në nenin 58, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Zëvendësdrejtori kryen detyrat që i delegohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”

Neni 9

Në nenin 59 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalja e dytë e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë:

“2. ...Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrin kandidat për zgjedhur bazuar në parimet e mundësive të barabarta, të meritokracisë dhe të mosdiskriminimit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.”

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Rastet e lirimit të shkarkimit, si dhe mandati i qëndrimit në detyrë për zëvendësdrejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit janë të njëjta me ato të drejtorit të departamentit.”

Neni 10

Në nenin 60 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtori i departamentit është autoriteti më i lartë i shërbimit policor të departamentit që drejton.”

2. Në pikën 3, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) propozon buxhetin e departamentit që drejton.”

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë:

“5. Drejtori i departamentit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe qëndron në detyrë për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rikurrimi edhe për një mandat të dytë. Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrin kandidat për drejtor departamenti pas kryerjes së një procesi konkurrimi të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor departamenti përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.”

Neni 11

Në nenin 61 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ dhe operacional i policisë në nivel vendor dhe përgjigjet te drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”

2. Paragrafi i parë, i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtori i Drejtorisë Vendore përzgjidhet nga radhët e rolit të mesëm drejtues, nëse plotëson njëkohësisht kriteret si më poshtë:”

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Drejtori i Drejtorisë Vendore emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”

Neni 12

Në nenin 62 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Shefi i komisariatit përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë që mbajnë gradën “komisar”



ose “kryekomisar” dhe plotësojnë kriteret si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të mos ketë masa në fuqi për shkelje të rënda disiplinore të policisë;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i tij bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë:

“4. Procedurat e përzgjedhjes së shefit të komisarit të policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.”.

Neni 13

Në nenin 66, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese. Numri dhe tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë dhe kategorizimi i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 14

1. Në nenin 69, pika 1, shkronjat “a/ii” dhe “b/iii” ndryshohen si më poshtë:

“a/ii. punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe shkollën në Kolegjin Profesional të Formimit Policor në Akademinë e Sigurisë ose të njësuar me të dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara;”.

“b/iii. punonjës nga institucionet e tjera të sigurisë, që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe shkollën në Kolegjin Profesional të Formimit Policor në Akademinë e Sigurisë ose të njësuar me të dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Punonjësit e pranuar sipas këtij neni i nënshtrohen trajnimit të detyruar 2-javor në Akademinë e Sigurisë.

4. Rregullat dhe procedurat e pranimi sipas këtij neni përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.”.

Neni 15

Nenet 72, 74 dhe 77 shfuqizohen.

Neni 16

1. Në nenin 78, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pranohen nëpërmjet procesit të konkurrimit në funksione të veçanta shtetasit të cilët, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 70 të këtij ligji, plotësojnë kriteret e veçanta që lidhen me fushën e arsimit apo me aftësitë specifike në atë fushë dhe që disponojnë diploma, specializime ose kualifikime të cilat nuk përfitohen në programet e ofruara në Akademinë e Sigurisë.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për pranimin në funksionet e veçanta, kandidati duhet të ketë jo më pak se 2 vjet përvojë pune në fushën përkatëse.”.

Neni 17

Në nenin 85, në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit i jep punonjësit të policisë gradën pasuese mbi bazën e vlerësimit të demonstrimit të një profesionalizmi të lartë, të kryerjes së një akti me karakter heroik, të një veprimi që tejkalon pritshmëritë në situata të rrezikshme dhe të paparashikueshme apo të dhënies së kontributit të drejtpërdrejtë në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, në shenjë mirënjohje dhe vlerësimi, me propozim të eprorit të punonjësit. Numri i gradave të dhëna sipas kësaj pike nuk mund të jetë më shumë se 2% e limitit të përgjithshëm të gradave policore.”.

Neni 18

Në nenin 86, pika 1, shkronja “dh”, nënndarjet “iii” dhe “iv” ndryshojnë si më poshtë:

- “iii. nga “komisar” në “kryekomisar” 4 vjet;
- iv. nga “kryekomisar” në “drejtues” 4 vjet;”.

Neni 19

Në nenin 100, pika 3 ndryshohet si më poshtë:



“3. Pushimi vjetor për punonjësit e policisë është 28 deri në 40 ditë pune dhe jepet në mënyrë të shkallëzuar sipas vjetërsisë dhe gradave të përcaktuara në rregulloren e Policisë së Shtetit.”.

Neni 20

Në nenin 117 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Rikthimi në Policinë e Shtetit bëhet kur ka vende të lira në funksionin dhe gradën korresponduese që punonjësi ka pasur në kohën e lirimit.”.

2. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 21

Në nenin 127, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep edhe certifikata për personelin e policisë.”.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr.481, datë 5.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 481, datë 5.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 90/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit””.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 472, datë 4.8.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Eges Genti Qejvanaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 473, datë 4.8.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënen e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Narta Mentor Kazazi

2. Ajet Skender Mirzo

3. Gentrin Sami Kastrati

4. Lorent Shaban Halilaj



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 474, datë 4.8.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Milot Fatmir Duraku
2. Tironika Teki Krasniqi
3. Alban Din Hoti
4. Dardan Riza Mulaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 475, datë 4.8.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ardona Dritan Daci
2. Andi Dritan Daci
3. Artan Isa Çupi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 477, datë 4.8.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edgar Robert Prifti
2. Teuta Gani Prifti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 478, datë 4.8.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kevin Enkel Halili
2. Sara Enkel Halili

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 5, datë 17.7.2026

PËR MIRATIMIN E FORMATEVE TË
RAPORTIMIT PERIODIK, TË PLANIT
VJETOR TË PUNËS, TË VEPRIMTARISË
MINERARE TË SHFRYTËZIMIT

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 23, të nenit 36, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Objekti

Ky udhëzim ka për objekt miratimin e formateve dhe procedurave, të cilat zbatohen nga zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, për:

a) raportimin periodik gjashtëmujor dhe vjetor të veprimtarisë minerare;

b) paraqitjen dhe miratimin e planit vjetor të punës.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen ndaj zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, të cilët janë pajisur me leje minerare nga ministri përgjegjës për sektorin minerar, në përputhje me legjislacionin minerar në fuqi.

Neni 3

Informacioni i gjashtëmujorit të parë

1. Informacioni i gjashtëmujorit të parë të veprimtarisë minerare, i paraqitur nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit, përmban:

a) të dhënat e shoqërisë dhe të lejes minerare, sipas formatit të parashikuar në aneksin 1 pjesë e këtij udhëzimi;

b) treguesit e realizuar, sipas formatit të parashikuar në aneksin 2 pjesë e këtij udhëzimi.

2. Informacioni për këtë periudhë dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), jo më vonë se data 15 e muajit kalendarik pasardhës, pas mbylljes së periudhës gjashtëmujore.

Neni 4

Informacioni vjetor

1. Informacioni vjetor i veprimtarisë minerare, i paraqitur nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit, përfshin:

a) të dhënat e shoqërisë dhe të lejes minerare, sipas formatit të parashikuar në aneksin 1 të këtij udhëzimi;

b) treguesit e realizuar, sipas formatit të parashikuar në aneksin 2, pjesë e këtij udhëzimi;

c) formati për gjendjen dhe lëvizjen e rezervave, sipas formatit të parashikuar në aneksin 4, pjesë e këtij udhëzimi;

ç) dokumentacionin sipas listës së parashikuar në aneksin 5, pjesë e këtij udhëzimi.

2. Informacioni vjetor dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, pranë AKBN-së, jo më



vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga mbyllja e vitit kalendarik.

3. Kur struktura përgjegjëse konstaton mosplotësimin e plotë e të saktë ose vendosjen e të dhënave joreale në formatin e raportimit vjetor, sipas anekseve përkatëse të këtij udhëzimi, ia kthen raportimin subjektit për plotësim ose korrigjim.

4. Subjekti, të cilit i kthehet raportimi, detyrohet të plotësojë ose korrigjojë mangësitë e konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e kthimit. Mosrespektimi i këtij detyrimi përbën shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë.

Neni 5

Plani vjetor i punës

1. Plani vjetor i punës hartohet dhe dorëzohet sipas formatit dhe dokumentacionit të parashikuara në aneksin 6, pjesë e këtij udhëzimi.

2. Të gjitha punimet minerare të hapjes, si dhe metodikat e përgatitjes dhe të shfrytëzimit, për vitin raportues e për vitin vijues, duhet të jenë në përputhje me projektin teknik të miratuar në Këshillin Teknik të AKBN-së.

3. Aplikimi dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së aktmiratimit të lejes minerare të caktuar nga ministri. Përfundimi nga ky parashikim bëjnë lejet e parashikuara në nenin 6, pjesë e këtij udhëzimi.

4. Kur struktura përgjegjëse konstaton mosplotësimin e plotë e të saktë të aplikimit për miratimin e planit vjetor të punës, sipas aneksit 6 pjesë e këtij udhëzimi, kërkon plotësimin ose korrigjimin e mangësive të konstatuara.

5. Subjekti, të cilit i kërkohet plotësimi, detyrohet të plotësojë ose korrigjojë dokumentacionin me mangësitë e konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al. Në rast mosmiratimi në kohë të planit vjetor të punës për mosplotësim të mangësive të konstatuara sipas afatit më sipër, AKBN-ja njofton subjektin, ministrinë dhe AKSEM-in. Rifillimi i veprimtarisë minerare lejohet vetëm pas miratimit të planit vjetor të punës.

6. Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga njoftimi i pezullimit subjekti nuk paraqet aplikimin për miratimin e planit vjetor, AKBN-ja propozon masën administrative.

Neni 6

Plani vjetor i punës për lejet që shtrihen në një plan në kuota të ndryshme

1. Për lejet minerare që janë pjesë të zonave: zona Bulqizë, zona Batër, zona Tërnovë, zona Lugu i Gjatë, zona Thekën dhe zona Krastë, si dhe kudo tjetër që shtrihen në një plan në kuota të ndryshme, plani vjetor i punës hartohet për vitin kalendarik 1 janar–31 dhjetor.

2. Formatit dhe përmbajtja e planit vjetor të punës janë në përputhje me parashikimet e nenit 5 të këtij udhëzimi.

3. Materiali grafik i planit vjetor realizohet në formatin vektorial 3D (AutoCAD ose ArcGIS), me të njëjtin sistem projeksioni të koordinatave për subjektet e licencuara në të njëjtin vendburim.

4. Plani vjetor i punës dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, pranë AKBN-së, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para përfundimit të vitit kalendarik.

5. Struktura përkatëse e AKBN-së shqyrton njëkohësisht materialet grafike të planeve vjetore të subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në të njëjtin vendburim dhe kanë kufij të përbashkët horizontalisht ose vertikalisht.

Neni 7

Veprimtaria e pezulluar

1. Subjektet me pezullim të përkohshëm të miratuar nga ministri, sipas pikës 2/1, të nenit 18 dhe 25, ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me afat mbi një vit, nuk përjashtohen nga detyrimi për raportim.

2. Në raportin teknik narrativ, subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni përshkruajnë punimet e mirëmbajtjes, të realizuara dhe ato të parashikuara deri në rinisjen e veprimtarisë.

3. Jo më vonë se një muaj para rifillimit të veprimtarisë, subjekti minerar paraqet aplikimin me dokumentacionin e plotë, sipas aneksit 6 pjesë e këtij udhëzimi.

4. Kur plani vjetor i punës për subjektet me pezullim të përkohshëm të miratuar nga ministri miratohet para datës së parashikuar sipas neneve 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, ai miratohet për periudhën e mbetur deri në datën e miratimit të planit të ardhshëm. Tarifa e miratimit nuk paguhet, duke u njohur tarifa e paguar gjatë periudhës së pezullimit.



Neni 8

Raporti përmbledhës për ministrinë

1. Struktura përgjegjëse (AKBN-ja) dorëzon pranë ministrisë raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të shfrytëzimit, brenda afateve të mëposhtme:

a) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga mbyllja e gjashtëmujorit të parë, për raportin gjashtëmujor;

b) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga mbyllja e vitit kalendarik, për raportin vjetor.

2. Raporti i parashikuar në pikën 1 të këtij neni përmban të dhëna, mbi:

a) realizimin e prodhimit;

b) vlerën dhe specifikimet për çdo zë të investimeve të realizuara;

c) respektimin e projektit mineral, frontet ku është ushtruar veprimtaria dhe punimet e reja minerare të kryera, në përputhje me projektin mineral dhe planin vjetor të punës;

ç) bilancin e rezervave minerare;

d) sipërfaqet e prekura nga aktiviteti mineral;

dh) sipërfaqet e rehabilituara dhe sasinë e mbetjeve minerare të depozituara;

e) kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit mineral.

Neni 9

Aksesi në portal dhe detyrimet e raportimit elektronik

1. Zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit pajisen me llogari aksesi (emër përdoruesi dhe fjalëkalim) në portalin: raport.akbn.gov.al. Kërkesa paraqitet me shkrim nga administratori i shoqërisë, sipas formatit të parashikuar në aneksin 1 pjesë e këtij udhëzimi.

2. Mungesa e llogarisë së aksesit sipas pikës 1 të këtij neni sjell pasojat e mosraportimit dhe zbatimin e masave administrative, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

3. Në rast pamundësie teknike të dokumentuar apo mosfunksionim të portalit për kryerjen e raportimeve, subjektet minerare i dorëzojnë ato brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar, pranë AKBN-së.

4. Të dhënat e raportuara nëpërmjet portalit të AKBN-së kanë për qëllim përcaktimin e treguesve teknologjikë të mirëshfrytëzimit të rezervave

minerare dhe prodhimin e statistikave të nevojshme për shtetin shqiptar.

Neni 10

Grupimi i mineraleve për raportim statistikor

1. Mineralet grupohen për raportim statistikor, në përputhje me kërkesat e INSTAT-it dhe EUROSTAT-it, sipas listës së mineraleve të parashikuar në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 11

Detyrimet institucionale dhe mbikëqyrja

1. AKBN-ja njofton të gjithë zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit dhe i trajnon ata mbi mënyrën e plotësimit të formularëve e të kryerjes së raportimeve nëpërmjet portalit, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

2. AKBN-ja vendos dhe propozon masat administrative pranë ministrisë për çdo subjekt mineral, në çdo rast mosrespektimi të përcaktimeve të këtij udhëzimi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. AKBN-ja, si institucioni i ngarkuar me zbatimin e këtij udhëzimi, përcakton sektorët dhe njësitë përkatëse të saj për përmbushjen e detyrimeve, sipas kompetencave të tij.

4. Drejtoria përgjegjëse e ministrisë mbikëqyr zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 12

Shfuqizimi

Urdhri nr. 201, datë 20.6.2016, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore” dhe urdhri nr. 202, datë 20.6.2016, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet”, i ndryshuar, shfuqizohen.



Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

ANEKS 1

FORMATI PËR TË DHËNAT E SHOQËRISË DHE LEJES MINERARE

1	Periudha raportuese		
a	Viti		
b	1	Gjashtëmujori i parë	▼
	2	Vjetori	
2	Të dhëna mbi shoqërinë operuese		
a	Emri i subjektit sipas QKB-së (zotëruesi i lejes ose nënkontraktori i miratuar nga ministri)		
b	NIPT-i		
c	Adresa e selisë së subjektit		
d	Numër telefoni		
e	Adresë <i>email</i> -i		
f	Emër mbiemër i administratorit		
g	Emër mbiemër i drejtuesit teknik		
h	Nr. i licencës së drejtuesit teknik		
i	Investimet me kapital:		
	1	vendas	▼
	2	të huaj	
	3	vendas dhe të huaj	
3	Identifikimi i lejes minerare		
a	Nr. i lejes (nr. i aktmiratimit nga ministri)		
b	Data e lejes (data në aktmiratim)		
c	Lloji i mineralit ose mineraleve për të cilin është dhënë leja minerare e shfrytëzimit		
	1	Mineral 1:	
	2	Mineral 2:	
	3	Mineral 3:	
d	Emërtimi i vendburimit (dhe kur ka disa leje apo nënkontraktor në një vendburim edhe emërtimi i pjesës ku ndodhet zona minerare e pjesës në administrim)		
e	Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti		
4	Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare		
a	Subjektit zotërues i lejes		
b	NIPT-i		
c	Emër mbiemër i administratorit		
e	Adresa e selisë së subjektit		
f	Adresë <i>email</i> -i		



ANEKS 2

**FORMATI PËR TREGUESIT E REALIZUAR: (PËR 6-MUJORIN E PARË DHE VJETOR,
PËR RAPORTIMIN VJETOR PLOTËSOHEN EDHE TABELAT NË VIJIM)**

Nr.		Emërtimi	Njësia	Kapaciteti vjetor i miratuar	Realizimi
1	K	Kapaciteti vjetor i miratuar në lejen minerare	ton m ³	▼	
2	a	Prodhimin mineral në total Tregues = K (konvertuar në ton), realizimi S (a1+a2+a3+...)	ton		
	a1	Sasia e produktit të mineralit 1	ton		
		Cilësia e produktit 1	%		
		Pesha volumore e mineralit 1 (produkt i shitshëm)	ton/m ³		
	a2	Sasia e produktit të mineralit 2	ton		
		Cilësia produktit 2	%		
		Pesha volumore e mineralit 2 (produkt i shitshëm)	ton/m ³		
	a3	Sasia e produktit të mineralit 3	ton		
		Cilësia produktit 3	%		
		Pesha volumore e mineralit 3 (produkt i shitshëm)	ton/m ³		
	a4	etj.	ton		
			%		
			ton/m ³		
	b	Nënproduktet e përpunuara Koncentrat ose Inerte të klasifikuara			
	b1	Sasia	ton		
		Cilësi	%		
	b2	Sasia	ton		
		Cilësi	%		
	b3	Sasia	ton		
		Cilësi	%		
3	c	Sasia e produkteve minerare të shitura në total S (c1+c2), në të njëjtën monedhë	ton		
	c*	Vlera e produkteve minerare të shitura në total S (c1*+c2*), në të njëjtën monedhë	Vlera		
	c1	Sasia produkteve minerare të shitura në vend	ton		
		Çmimi mesatar i shitjes në vend	Lek/ton		
	c1*	Vlera e produkteve minerare të shitura në vend	Lekë		
	c2	Sasia e produkteve minerare të eksportuara	ton		
		Çmimi mesatar i shitjes në eksport	Lek/ton		
	c2*	Vlera e produkteve minerare të eksportuara	Lekë		
		Pagesa e rentës minerare	Lekë		
4	d	Investimet në natyrë (punime minerare të kryera)			
		Punime kapitale	ml		
		Punime përgatitore ose kërkimi	ml		
		Shpime gjeologjike	ml		
		Transhe, rrugë	ml		
		Sheshe	m ²		
		Zbulim në karriera	m ³		
		Depozitim steriles (punimesh nëntokësore ose zbulimi në karriera)	m ³		
		Investimet në vlerë S (d1+d2+d3)	Lekë		
	d1	Punime minerare të kryera	Lekë		
	d2	Rilevime dhe projekte	Lekë		
	d3	Makineri e pajisje dhe ndërtim montime	Lekë		
5		Fuqia punëtore në total	Nr.		
6		Fuqia punëtore me sigurim jete	Nr.		
7		Pagesa e garancisë së rehabilitimit (vjetore)	Lekë		

Administratori i shoqërisë

Emër, mbiemër, firmë

Vula:

Vendi dhe data:

Shënim. Vetëm për raportimin vjetor, plotësohen tabelat sipas përcaktimeve:

Për subjektet që shesin tek të tretet mineral ose fraksione të tij vetëm nga leja në zotërim vetëm tabelën 1.

Për subjektet që shesin tek të tretet koncentrat, tabela 1 dhe tabela 2.

Për subjektet që shesin tek të tretet produkt ndryshe nga minerali dhe koncentrat (p.sh. çimento, ferrokrom etj.), por furnizohen me lëndë të parë nga minerali i shfrytëzuar nga lejet e tyre minerare vetëm tabelën 2.

**Tabela 1. Përmbledhëse e shitjeve (janar–dhjetor) mbështetur tek faturat tatimore të shitjeve.**

Nr.	Muaji	Emërtimi (përshkrimi) i mallit	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi mesatar për njësi me TVSH (lek/ton)	Vlefëta me TVSH (lek)
1	Janar	Produkt ose nënprodukt 1				
		Produkt ose nënprodukt 2				
		.				
.	.					
.	.					
12	Dhjetor	Produkt ose nënprodukt 1				
		Produkt ose nënprodukt 2				
		.				
Shuma sasia →					Shuma vlefëta →	

Administratori i shoqërisë

Emër, mbiemër, firmë

Vula:

Vendi dhe data:

Tabela 2. Përmbledhëse e furnizimit me mineral (janar–dhjetor) të fabrikës ose uzinës, mbështetur tek faturat e shoqërimit të mallit

Nr.	Muaji	Njësia e matjes	Sasia nga prodhimi nga lejet që zotëron (ton)	Cilësia (%)	Sasia nga blerjet tek të tretët (ton)	Cilësia (%)
1	Janar					
.	.					
.	.					
12	Dhjetor					
Shuma për sasinë - dhe cilësia e ponderuar						

Administratori i shoqërisë

Emër, mbiemër, firmë

Vula:

Vendi dhe data:

Tabela 3. Gjendje minerali dhe nënprodukte në stok në sheshin e minierës në fund të muajit dhjetor të vitit që mbyllet.

Nr.	Emërtimi	Koment me emërtimin e sakte të produktit	Njësia e matjes	Sasia	Cilësia
1	Mineral 1		ton		
2	Nënprodukt 1		ton		
3	Nënprodukt 2		ton		
.					



ANEKS 3

PARASHIKIMI I TREGUESVE KRYESORE TË PRODHIMIT PËR VITIN NË VIJIM

Nr.		Emërtimi	Njësia	Parashikimi	
				Gjashtëmuji i parë	Vjetori
1	a	Prodhimi mineral në total (konvertuar në ton), realizimi $S (a_1 + a_2 + a_3 + \dots a_n)$	ton		
	a ₁	Sasia e produktit të mineralit 1	ton		
		Cilësia e produktit 1	%		
	a ₂	Sasia e produktit të mineralit 2	ton		
		Cilësia produktit 2	%		
	a ₃	Sasia e produktit të mineralit 3	ton		
		Cilësia produktit 3	%		
	a _n	etj.			
					
					
	b	Nënproduktet e përpunuara Koncentrat ose inerte të klasifikuara			
	b1	Sasia	ton		
		Cilësi	%		
	b2	Sasia	ton		
		Cilësi	%		
	b3	Sasia	ton		
		Cilësi	%		
2	c	Investimet në natyrë (punime minerare)			
		Punime kapitale	ml		
		Punime përgatitorë ose kërkimi	ml		
		Shpime gjeologjike	ml		
		Transhe, rrugë	ml		
		Sheshe	m ²		
		Zbulim në karriera	m ³		
	d	Investime në projektim dhe makineri pajisje			
		Rilevime dhe projekte	Lekë		
		Makineri e pajisje dhe ndërtim montime	Lekë		

ANEKS 4

FORMATI PËR GJENDJEN DHE LËVIZJEN E REZERVAVE

Nr.	Lloji dhe kategoria e rezervave		Sasia		Cilësia	
1	Njësitë →		ton	▼	%	▼
			m ³		gr/ton	
2	Rezervat e nxjerrshme, dhënë në lejen minerare					
3	Rezerva të shfrytëzuara nga data e marrjes së lejes minerare					
4	Rezervat e nxjerrshme gjendja në fillim të vitit raportues					
	a1	Rezervat e shfrytëzuara gjatë vitit raportues				
	a2	Rezervat e shtuara deri fund të vitit raportues (vërtetuar me punime kërkim-zbulimi të dokumentuara)				
5	Rezervat gjeologjike të nxjerrshme gjendje në fund të vitit raportues: nga këto: $(4 - a1 + a2) = (b1 + b2 + b3)$					
	b1	Rezerva të hapura (ka shkuar punimi kapital deri tek trupat, traverbank galeri, rampe, dishanderi etj., për nëntokë dhe është ndërtuar transheja apo rruga kryesore deri në nivelin e fillimit të shfrytëzimit për karrierat)				
	b2	Rezerva të përgatitura (janë hapur punimet e katit (nivelet) për nëntokë, dhe janë ndërtuar rrugët hyrëse për shkallët sipas projektit për karrierat)				
	b3	Rezerva të gatshme (janë hapur punimet e bllokut dhe kanë filluar nënkatet për nëntokë, dhe janë ndërtuar sheshet e shfrytëzimi në shkallët sipas projektit në karrierat)				



ANEKS 5

Dokumentacioni që duhet të plotësohet dhe ngarkohet krahas plotësimit të anekseve 1, 2, në portalin: raport.akbn.gov.al, për raportimin vjetor të aktivitetit

1. Mandat pagesa e garancisë së rehabilitimit për vitin që mbyllet, sipas formularit të lëshuar nga zyra përkatëse në ministrinë e linjës.
2. Tabelat në vijim të aneksit 2 (tabelat 1, 2 dhe 3) (të firmosura dhe vulosura).
3. Aneksi 3 (firmosur dhe vulosur).
4. Aneksi 4 (firmosur dhe vulosur).
5. Mandatpagesat e rentës minerare.
6. Mandatpagesat e taksave lokale për vitin që mbyllet, sipas përcaktimit në formularin e njësisë vendore ku kryhet aktiviteti.
7. Vërtetim nga tatim taksat mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore (renta minerare).

ANEKS 6

Dokumentacioni që duhet të plotësohet dhe ngarkohet në portalin: raport.akbn.gov.al, për aplikimin për miratim të planit vjetor të punës.

1. Raporti teknik i punës së kryer, punimet minerare dhe shfrytëzimi i mineralit, për vitin që mbyllet dhe parashikimi i punimeve minerare dhe të shfrytëzimit për vitin në vijim.
2. Dokumente teknike (planimetri, prerje, etj.).
3. Autorizimi për punë me LP.
4. Licenca e drejtuesit teknik.
5. Kontrata e punës me drejtuesin teknik.
6. Formulari Esig-03 (për drejtuesin teknik).
7. Mandatpagesa e garancisë së rehabilitimit.
8. Mandatpagesa e tarifës së shqyrtimit të planit vjetor të punës.

Shënim. Materialet që ngarkohen në portal vendosen në dosje dhe paraqiten në strukturën e caktuar nga AKBN-ja për trajtimin e tyre.

Përshkrimi i përmbajtjes së raportit teknik.

1. Pjesa prezantuese dhe informuese.

Raporti fillon me të dhënat e shoqërisë dhe lejes minerare të përcaktuara sipas formatit në aneksin 1, vazhdohet me tabelën e treguesve të realizuar për vitin kalendarik të mbyllur (tabela që është plotësuar në raportimin vjetor sipas aneksit 2), më pas vendoset tabela me parashikimin e treguesve kryesore të prodhimit për vitin në vijim (aneksi 3) dhe në vijim të tyre plotësohet tabela me treguesit e prodhimit dhe shitjeve të realizuara nga muaji janar deri në muajin e mbyllur para datës së aplikimit, si në modelin e tabelës, më poshtë:

Nr.	Muaji	Prodhim Minerali (ton)	Cilësia (%)	Prodhim Koncentrati (ton)	Cilësia (%)	Shitje minerali ose nënproduktesh të tij (ton)	Shitje koncentratit (ton)
1	Janar						
2	Shkurt						
3	Mars						
4	.						



5	.						
6	.						
7	.						
8	.						
9	.						
10	.						
11	Nëntor						
Shuma							

P.sh. subjekti që aplikon me 22 korrik, e plotëson tabelën nga janari deri në qershor.

2. Informacioni gjeologjik dhe rezervat e mineralit.

Përgatitet një relacion i shkurtër gjeologjik me të dhëna të përmbledhura saktë për emërtimet e mineralizimit dhe shkëmbinjve rrethues të vendburimit. Kur ka zhvillim të punimeve të reja gjeologjike, ato paraqiten në detaje. Sipas metodikave e teknikave gjeologjike, kur shtohen rezervat jepen me tabelë të dhënat për punimet e kryera, sipas llojit të tyre, kanale, pusëza, shpime, galeri. Po ashtu ndërtohen tabelat përkatëse për rezervat e shtuara me treguesit sasior e cilësor.

Kjo pjesë mbyllet me tabelën për gjendjen dhe lëvizjen e rezervave (tabela që është plotësuar në raportimin vjetor sipas aneksit 4).

3. Përshkrimi i detajuar i punimeve minerare, si dhe punimet e përgatitjes dhe rrëzimit të mineralit për të gjithë aktivitetin e realizuar gjatë një viti. Llogaritja e sasisë së rezervave të marra për çdo bllok apo trup minerar. Përshkrimi i vendeve nëntokë apo sipërfaqe nga ku kanë dalë sterilet, sasia e tyre dhe venddepozitimi i tyre. Punimet e realizuara për rehabilitimin e mjedisit. Përshkrimet e bëra për sa u përçaktua më lart, të përputhen saktë me paraqitjet respektive të atyre punimeve në materialin grafik.

4. Përshkrimi sqarues i punimeve minerare apo gjeologjike që janë parashikuar, si dhe ato të rrëzimit të mineralit për të gjithë aktivitetin e planifikuar për vitin në vijim. Llogaritja e sasisë së rezervave që do të merren për çdo bllok apo trup minerar. Parashikimi i rehabilitimit për sipërfaqet ku ka mbaruar aktiviteti minerar apo stoqeve të depozitimit të sterileve që janë mbushur sipas përcaktimeve në projektin e miratuar në këshillin teknik apo rehabilitimin pjesor të tyre në sipërfaqet që nuk ka rrezik dëmtimi nga depozitimet në vijim. Përshkrimi i punimeve minerare, të shfrytëzimit dhe të rehabilitimit të parashikuar, si dhe rezervat që do

të shfrytëzohen, të përputhen saktë me paraqitjet respektive të atyre punimeve në materialin grafik.

5. Raporti mbyllet me strukturën e burimeve njerëzore të angazhuar në aktivitetin minerar të lejes përkatëse të shfrytëzimit, si dhe një listë të makinerive, pajisjeve apo linjave të përpunimit që përdoren për realizimin e aktivitetit minerar.

6. Materialin grafik.

a) Planimetria e përgjithshme në shkallë të tillë që të jetë paraqitur i gjithë konturi i lejes minerare sipas koordinatave të miratuar në aktmiratim nga ministri. Në këtë planimetri të paraqiten të gjithë zonat minerare ku është kryer aktiviteti minerar në çdo kohë qoftë duke vendosur brenda çdo zonë ku është kryer aktiviteti minerar, vitin e kryerjes së aktivitetit atje. Për këtë planimetri dhe materiale të tjera grafike që përcaktohen në vijim, punimet e kryera para vitit raportues do të paraqiten me ngjyrë të zezë, punimet e kryera gjatë vitit që raportohet do të paraqiten me ngjyrë të kuqe dhe punimet e planifikuara për vitin në vijim me ngjyrë jeshile. Topografia e zonës së licencuar minerare, paraqitur në planimetritë e materialit grafik do të jetë në saktësinë hartografike: për minierat nëntokësore jo më e vogël se 1:5000 dhe për karrierat jo më e vogël se 1:1000.

b) Planimetritë dhe profilet e punës ku paraqitet aktiviteti minerar i zhvilluar për vitin që u mbyll dhe aktiviteti minerar i parashikuar për vitin në vijim. Shkalla e paraqitjes 1:500 dhe kur është e nevojshme për saktësim të mëtejshëm edhe 1:200.

Në çdo rast do të paraqiten të gjitha punimet ekzistuese (edhe ato që nuk përdoren). Veç punimeve që do të paraqiten me ngjyrat e përcaktuara, do të paraqiten edhe hapësirat e shfrytëzuara me konture të sakta, me vijëzim (*hatch*) me ngjyrat që tregojnë kohën e shfrytëzimit, si edhe tek punimet minerare (e zezë, e kuqe dhe jeshile).

Po ashtu në profile gjithnjë duhet të jenë paraqitur shpimet gjeologjike dhe rezultatet e



kapjeve, qoftë nga shpimet apo nga punimet e kërkimit. Kur zona aktive e shfrytëzimit është në mes të profileve normale të përcaktuara që në raportin gjeologjik, përgatiten profile të ndërmjetme plotësuese për të pasur të qartë punimet që mundësojnë aktivitetin në atë zonë.

c) Punimet e kërkimit apo shpime gjeologjike që mund të jenë kryer gjatë vitit pasqyrohen në materialin grafik të punës. Kur punimet apo shpimet gjeologjike janë bërë në një zonë të re të vendburimit, por sigurisht brenda kontureve të lejes, paraqiten në planimetri e profile plotësuese më vete. Në të dyja rastet, bashkë me punimet e hartografuara, reflektohet edhe dokumentimi dhe interpretimi gjeologjik i tyre. Planimetritë duhet të jenë të firmosura nga Ing. gjeolog që i ka ndjekur dhe interpretuar ato.

d) Për minierat sipërfaqësore, paraqiten edhe: pasaporta e shfrytëzimit të miratuar dhe ajo faktike e realizuar për karrierën me elementet e llogaritur të lartësisë së shkallës, gjerësisë së sheshit të shkallës dhe shesheve të punës, pjerrësisë së skarpatës së shkallës, si dhe këndi i shpatit total të karrierës.

e) Për minierat nëntokësore, paraqiten edhe: lloji i ajrimit që përdoret, vizatimi perspektiv (pamje 3D), si dhe skema kanonike e ajrimit të minierës, të përditësuara. Rugën e hyrjes së ajrit të pastër (me blu), ajrimin e fronteve të punës dhe rrugët e largimit, deri në dalje të ajrit të papastër (me të kuqe). Po ashtu të paraqiten pozicionet e vendosjes së ventilatorëve lokal që janë në përdorim, si dhe pozicioni i vendosjes së ventilatorit qendror. Pasaportat e shpimplasjes dhe armatimit të punimeve minerare. Pasaporta e shfrytëzimit të bllokut. Skema e rrjetit të furnizimit me ajër të ngjeshur. Skema e rrjetit të furnizimit me ujë për shpimin e lagur. Skema e rrjetit të nxjerrjes së ujërave nëntokësore, si dhe treguesit e cilësisë së ujit që del nga miniera, PH dhe materiali inert pezull në të.

² Ky urdhër përafron plotësisht rregulloren e Komisionit Evropian nr. 255/2010, datë 25 mars 2010, “Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta në menaxhimin e fluksit të trafikut ajror”. Numri CELEX 32010R0255, botuar në Fletoren Zyrtare L. 80, datë 26.3.2010, ndryshuar nga Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 923/2012, datë 26 shtator 2012, që përcakton rregullat e përbashkëta të fluturimit dhe dispozitat operacionale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat e lundrimit ajror, si dhe që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) nr. 1035/2011 dhe Rregulloret (KE) nr. 1265/2007, (KE) nr. 1794/2006, (KE) nr. 730/2006 dhe (BE) nr. 255/2010, Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 2016/1006,

URDHËR

Nr. 181, datë 30.7.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES QË PËRCAKTON RREGULLAT E PËRBASHKËTA MBI MENAXHIMIN E FLUKSIT TË TRAFIKUT AJROR²

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës “ç”, të nenit 7 dhe të nenit 87, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, “Për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores që përcakton rregullat e përbashkëta mbi menaxhimin e fluksit të trafikut ajror, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Urdhri nr. 281, datë 14.10.2014, “Për miratimin e rregullores që përcakton rregullat e përbashkëta mbi menaxhimin e fluksit të trafikut ajror”, shfuqizohet.

3. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky urdhër shfuqizohet.

4. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

datë 22 qershor 2016, që ndryshon Rregulloren e BE-së nr. 255/2010, në lidhje me dispozitat e ICAO-s të përmendura në nenit 3, paragrafi. Numri CELEX 32016R1006, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së OJ L. 165, datë 23.6.2016 dhe nga Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 2017/2159, datë 20 nëntor 2017, që ndryshon Rregulloren e BE-së nr. 255/2010, në lidhje me disa referenca ndaj dispozitave të ICAO-s. Numri CELEX 32017R2159, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së OJ L. 30, datë 21.11.2017.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

RREGULLORE
QË PËRCAKTON RREGULLAT E
PËRBASHKËTA MBI MENAXHIMIN E
FLUKSIT TË TRAFIKUT AJROR

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për menaxhimin e fluksit të trafikut ajror (në vazhdim MFTA) në mënyrë që të përsosë kapacitetin e disponueshëm të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror (në vazhdim RREMTA nën frymën e optimizimit të rrjetit evropian të menaxhimit të trafikut ajror (në vazhdim RREMTA) dhe të përmirësojë proceset e MFTA-së.

2. Kjo rregullore zbatohet brenda hapësirës ajrore të përmendur në nenin 1(1.2), të kapitullit II, të udhëzimit nr. 7, datë 3.6.2010, “Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian” (Rregullore për Hapësirën Ajrore), të ndryshuar që përafron rregulloren (KE) nr. 551/2004, për:

a) të gjitha fluturimet e destinuara për të operuar ose që operojnë si trafik i përgjithshëm ajror dhe në përputhje me rregullat e fluturimit instrumental (në tekstin e mëtejme IFR) plotësisht ose pjesërisht;

b) të gjitha fazat e fluturimeve të përmendura në pikën “a” dhe menaxhimin e trafikut ajror.

3. Kjo rregullore duhet të zbatohet për palët e mëposhtme ose personat që veprojnë në emër të tyre, të përfshira në proceset MFTA:

a) operatorët e avionit;

b) njësitë e shërbimit të trafikut ajror (në vazhdim SHTA), përfshirë zyrat e raportimit të SHTA-së dhe shërbimet e kontrollit të aerodromit;

c) shërbimet e informacionit aeronautik;

d) subjektet e përfshira në menaxhimin e hapësirës ajrore;

e) organet menaxhuese të aeroportit;

f) njësinë qendrore për MFTA-në;

g) njësitë lokale të MFTA-së;

h) koordinatorët e slotëve të aeroporteve të koordinuara.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e parashikuara në shtojcën 1, të udhëzimit nr. 5, datë 3.6.2010, “Mbi krijimin e strukturës së Qiellit të Vetëm Evropian” (kuadri rregullator), të ndryshuar që përafron rregulloren (KE) nr. 549/2004 dhe nenin 2 të “Rregullores për organizimin e procesit të alokimit të slotëve në aeroporte”, të miratuar me urdhrin nr. 84, datë 9.9.2011.

Gjithashtu, do të zbatohen përkufizimet në vijim:

1. **“Masa të menaxhimit të fluksit të trafikut ajror (MFTA)”**, nënkupton veprimet e ndërmarra për të kryer menaxhimin e fluksit të trafikut ajror dhe menaxhimin e kapaciteteve.

2. **“Operator”** nënkupton një person, organizatë ose ndërmarrje, e cila angazhohet ose ofrohet për t’u angazhuar në drejtimin e operimit të një avioni.

3. **“IFR”** nënkupton simbolin e përdorur për të përcaktuar rregullat e fluturimit instrumental.

4. **“Zyra e raportimit të shërbimeve të trafikut ajror (SHTA)”** nënkupton një njësi të SHTA-së e themeluar me qëllim të marrjes së raporteve, në lidhje me SHTA-në dhe planifikimin e fluturimeve të paraqitura para dorëzimit të parë të autorizimit të kontrollit të trafikut ajror.

5. **“Njësia lokale e menaxhimit të fluksit të trafikut ajror (MTFA)”** nënkupton një njësi të menaxhimit të fluksit, e cila operon në emër të një ose më shumë enteve të menaxhimit të fluksit si ndërlidhës midis njësisë qendrore për MFTA-në dhe një njësie të SHTA-së ose një grup të njësive të tilla.

6. **“Ngjarja kritike”** nënkupton një situatë të pazakontë apo krize, e cila përfshin një humbje të madhe të kapacitetit të rrjetit evropian të menaxhimit të trafikut ajror RREMTA ose një çekuilibër të madh midis kapacitetit dhe kërkesës së RREMTA-s, ose një mosfunksionim të madh në fluksin e informacionit në një ose disa pjesë të RREMTA-s.

7. **“Sloti i nisjes së menaxhimit të fluksit të trafikut ajror (MFTA)”** nënkupton kohën e llogaritur mirë të ngritjes, e dhënë nga njësia qendrore për MFTA-në me një kohë tolerancë të menaxhuar nga njësia lokale SHTA.



8. **“Orientimi i rrugëve dhe trafikut”** nënkupton politikat dhe procedurat për përdorimin e rrugëve nga avioni.

9. **“Plani i shumëfishtë i fluturimit”** nënkupton më shumë se një plan fluturimi për të njëjtin fluturim midis dy aeroporteve.

10. **“Konfigurimi i sektorit të njësisë së shërbimit të trafikut ajror (SHTA)”** nënkupton përshkrimin katërdimensional të sektorit SHTA të njësisë së hapësirës ajrore ose grupi sektorësh, të cilët mund të operojnë mbi një bazë të përhershme, ose të përkohshme.

11. **“Koha e taksisë së aerodromit”** nënkupton vlerën e paracaktuar kohore nga vendi i qëndrimit deri në nisje, e shprehur në minuta dhe e vlefshme gjatë operacioneve normale të aeroportit.

12. **“Pozicioni i përditësuar i fluturimit”** nënkupton pozicionin e avionit, i përditësuar nga të dhënat e vëzhgimit, të dhënat e planit të fluturimit ose raportet e pozicionit.

13. **“Autorizimi i kontrollit të trafikut ajror”** nënkupton autorizimin për një avion për të vepruar nën kushtet e specifikuar nga një njësi e kontrollit të trafikut ajror.

14. **“Pezullimi i planit të fluturimit”** nënkupton procesin e iniciuar nga një organizëm i MFTA-së për t’u siguruar se është bërë një ndryshim në planin e fluturimit nga operatori para kryerjes të fluturimit.

15. **“Shërbim ajror”** nënkupton një fluturim ose një seri fluturimesh që transportojnë pasagjerë, mallra ose postë për pagesë, ose qira.

16. **“Regjistri operacional”** nënkupton një regjistrë të sistemit MFTA, i konvertuar në një bazë të dhënash për të lejuar kërkimin e shpejtë të të dhënave MFTA.

Neni 3

Struktura e menaxhimit të fluksit të trafikut ajror

1. Planifikimi, koordinimi dhe zbatimi i masave MFTA nga ana e palëve të referuara në nenin 1 (3), duhet të pajtohet me dispozitat e ICAO-s të specifikuar në shtojcë.

2. MFTA-ja duhet të drejtohet nga parimet e mëposhtme:

a) masat MFTA duhet:

i. të parandalojnë kërkesat e tepruara të trafikut ajror krahasuar me kapacitetin e deklaruar të trafikut ajror (KTA) të sektorëve dhe aeroporteve;

ii. të përdorë kapacitetin e RREMTA-s në masën maksimale të mundshme, në mënyrë që të përsosë efikasitetin e MFTA-së dhe të minimizojnë efektet negative mbi operatorët;

iii. të përsosë kapacitetin e RREMTA-s të vënë dispozicion nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të kapaciteteve të masave të siguruar nga njësitë SHTA;

iv. të mbështesë menaxhimin e ngjarjeve kritike;

b) njësitë lokale MFTA dhe njësi qendrore për MFTA-në duhet të konsiderohet si pjesë e funksionit MFTA.

3. Caktimit të slotit të nisjes MFTA duhet t’i jepet prioritet për fluturimet sipas rendit të hyrjes së tyre të planifikuar në vendin ku do të aplikohen masat MFTA, përveç nëse rrethanat e veçanta kërkojnë aplikimin e një rregulli të ndryshëm prioritar për të cilin është rënë dakord zyrtarisht dhe është në dobi të RREMTA-s.

Nënpagrafi i parë mund të aplikohet për fluturime, të cilat nuk janë në gjendje të pranojnë opsionin e një rruge tjetër për të shmangur ose zbutur zonat e mbushur plot, duke marrë parasysh vendndodhjen dhe shtrirjen e zonës dendur.

Neni 4

Detyrimet e përgjithshme të AAC-së

1. AAC-ja duhet të sigurojë që funksioni i MFTA-së është në dispozicion të palëve të referuara në nenin 1(3) gjatë 24 orëve.

2. Përkufizimi dhe zbatimi i masave MFTA do të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes, në mënyrë që të sigurohet planifikimi efikas i hapësirës ajrore, ndarja dhe përdorimi për përfitimin e palëve referuar në nenin 1(3).

3. Procedura e qëndrueshme duhet të themelohet për bashkëpunim ndërmjet palëve të përfshira në funksionin MFTA, njësitë SHTA dhe subjektet e përfshira në menaxhimin e hapësirës ajrore, në mënyrë që të përsosë përdorimin e hapësirës ajrore.

4. Duhet të krijohet një dokument i përbashkët referimi me vendet e BE-së, që përmban politikat, procedurat dhe përshkrim për orientimin e rrugëve dhe trafikut. Aty ku aplikohet, publikimi i disponueshmërisë së rrugëve në publikimet e



informacionit aeronautik kombëtar duhet të jenë plotësisht në përputhje me këtë dokument reference të përbashkët.

5. Procedurat e përbashkëta për të kërkuar përjashtimin nga një slot nisjeje MFTA duhet të hartohen në përputhje me dispozitat e ICAO-s të specifikuara në shtojcë. Këto procedura do të koordinohen me njësinë qendrore për MFTA-në dhe duhet të botohen në publikimet kombëtare të informacionit aeronautik.

Neni 5

Detyrimet e AAC-së në lidhje me njësinë qendrore për MFTA-në

AAC-ja duhet të sigurojnë që njësia qendrore për MFTA-në:

a) të përsosë efektet e performancës së përgjithshme mbi MFTA-në, me anë të planifikimit, koordinimit dhe zbatimit të masave të MFTA-së;

b) këshillohet me operatorët në përcaktimin e masave të MFTA-së;

c) të sigurojë zbatimin efektiv të masave për MFTA-në, së bashku me njësitë lokale MFTA;

d) në koordinim me njësitë lokale MFTA, identifikon rrugët alternative për të shmangur ose zbutur zonat e dendura, duke marrë parasysh efektet e përgjithshme të performancës në MFTA;

e) ofron një rrugë tjetër alternative për ato fluturimet që do të përsosin efektin e pikës “d”;

f) siguron informacion mbi MFTA-në në kohën e duhur ndaj operatorëve dhe njësive të SHTA-së, duke përfshirë:

i. masat e planifikimit MFTA;

ii. ndikimin e masave MFTA në kohën e ngritjes dhe profilin e fluturimit të fluturimeve individuale;

g) monitoron zhvillimin e planeve të fluturimeve të humbura dhe planeve të fluturimit shumëfishe që janë ngritur;

h) pezullon planin e fluturimit, duke marrë parasysh tolerancën kohore, sloti i nisjes ATFM nuk mund të plotësohen dhe koha e qëndrimit e vlerësuar nuk është e njohur;

i) monitoron numrin e përjashtimeve të garantuara në përputhje me nenin 4(5).

Neni 6

Detyrimet e përgjithshme të njësive të SHTA-së

1. Kur duhet të zbatohet një masë MFTA, njësitë e SHTA-së duhet të koordinohen nëpërmjet njësive lokale MFTA me njësinë qendrore për MFTA-në, në mënyrë që të sigurohet se zgjedhja e masës është bërë me qëllim përsosjen e efekteve të përgjithshme të performancës së RRMTA-së.

2. Kur është e nevojshme, zyrat e raportimit SHTA duhet të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit midis pilotëve ose operatorëve dhe njësive lokale ose qendrore për MFTA-në.

3. Njësitë SHTA duhet të sigurojnë që masat e MFTA-së të aplikuar për aeroportet janë të koordinuara me organizmin menaxhues të aeroportit në fjalë, në mënyrë që të sigurojnë efikasitetin në planifikimin dhe përdorimin e aeroportit në dobi të palëve, referuar në nenin 1(3).

4. Njësitë SHTA duhet të njoftojnë njësinë qendrore për MFTA-në nëpërmjet njësive lokale MFTA të gjitha ngjarjet që mund të ndikojnë aftësinë e kontrollit të trafikut ajror ose kërkesat e trafikut ajror.

5. Njësitë SHTA duhet të sigurojnë njësinë qendrore për MFTA-në me të dhënat e mëposhtme dhe të përditësuara, në kohën e duhur dhe për të siguruar cilësinë tyre:

a) disponueshmërinë e hapësirës ajrore dhe strukturës së rrugës;

b) konfigurimin dhe aktivizimin e sektorit të njësive SHTA;

c) kohën e taksimit (lëvizje) në aerodrom;

d) sektorin e kontrollit të trafikut ajror dhe kapacitetet e aeroportit;

e) disponueshmërinë e rrugës, duke përfshirë disponueshmërinë nëpërmjet aplikimit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore, në përputhje me udhëzimin e ministrit të Transporteve nr. 10, datë 3.6.2010, “Rregullore e përbashkët për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore”;

f) pozicionet e fluturimit të përditësuar;

g) devijimet nga planet e fluturimit;

h) disponueshmëria e hapësirës ajrore, duke përfshirë disponueshmërinë nëpërmjet aplikimit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore, në përputhje me udhëzimin e ministrit nr. 10, datë 3.6.2010, “Për rregulloren e përbashkët të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore”;



i) koha aktuale e nisjes së fluturimit.

Të dhënat duhet të vihen në dispozicion të palëve të referuara në nenin 1(3) dhe të ofrohen falas për, dhe nga njësia qendrore për MFTA-në.

6. Njësia SHTA në aeroportin e nisjes duhet të sigurojë, që:

a) kur një fluturim është objekt i një sloti nisjeje MFTA, ky slot është përfshirë si pjesë e autorizimit (leje) të kontrollit të trafikut ajror;

b) fluturimet të respektojnë slotet e nisjes MFTA;

c) fluturimet që respektojnë kohën e nisjes së parashikuar, duke marrë parasysh kohën e tolerancës, nuk marrin autorizim nisjeje;

d) fluturimet, plani i të cilave është refuzuar ose anuluar nuk marrin autorizim ngritjeje.

Neni 7

Detyrimet e përgjithshme të operatorëve

1. Çdo fluturim i planifikuar duhet të ketë një plan të vetëm fluturimi. Plan i paraqitur i fluturimit duhet të pasqyrojë saktë profilin e synuar të fluturimit.

2. Të gjitha masat përkatëse MFTA dhe ndryshimet në to duhet të përfshihen në planin operacional të fluturimit dhe t'i komunikohen pilotit.

3. Kur nisen nga një aeroport që nuk është objekt rregullimi i një sloti nisjeje MFTA, operatorët janë përgjegjës për të respektuar në kohën e tyre të parashikuar të lëvizjes, duke marrë parasysh një tolerancë kohore të përcaktuara në dispozitat e ICAO-s, të specifikuara në shtojcë.

4. Kur një plan fluturimi është pezulluar në përputhje me nenin 5 (h), operatori i interesuar duhet të marrë masa për përditësimin ose anulimin e planit të fluturimit.

Neni 8

Detyrimet e përgjithshme të organeve drejtuese të aeroportit

Organet menaxhuese të aeroportit do të njoftojnë njësine qendrore për MFTA-në, drejtpërdrejt ose nëpërmjet njësisë lokale MFTA, ose njësive SHTA, ose të dyja, për të gjitha ngjarjet që mund të ndikojnë në kapacitetet e kontrollit të trafikut ajror ose kërkesat e trafikut ajror. Ata duhet informojë njësine lokale MFTA dhe njësitë SHTA ku njoftimi është bërë direkt.

Neni 9

Konsistenca midis planeve të fluturimit dhe slotëve të aeroportit

1. AAC-ja duhet të sigurojë që, kur kërkohet nga një koordinator i slotit të aeroportit ose nga një organ drejtues i një aeroporti të koordinuar, njësia qendrore për MFTA-në apo njësitë lokale MFTA duhet t'i sigurojnë atyre planin e fluturimit të pranuar të një fluturimi që operon në atë aeroport, para se të zhvillohet fluturimi. Koordinatorët e slotit të aeroportit apo organet drejtuese të aeroporteve të koordinuara duhet të organizojnë aksesin për planet e fluturimeve të pranura të siguruara në një njësi qendrore për MFTA-në ose njësi lokale MFTA.

2. Para fluturimit, operatorët duhet t'u sigurojnë aeroporteve informacionin e nevojshëm për nisjen dhe mbërritjen, për të mundësuar një korrelacion midis përcaktuesit të fluturimit të përfshirë në planin e fluturimit me atë të regjistruar në slotin e aeroportit përkatës.

3. Çdo operator, organizëm i menaxhimi të aeroportit dhe njësia SHTA ka të drejtën e raportimit të koordinatori i slotit të aeroportit, për operacionet e përsëritura të shërbimeve ajrore kur ato janë shumë të ndryshme nga slotet e caktuara të aeroporteve ose me përdorimin e slotëve në mënyrë shumë të ndryshme nga ajo e treguar në kohën e përcaktuar, në rastin kur kjo dëmton aeroportin ose operacionet e trafikut ajror.

4. AAC-ja duhet të sigurojë se njësia qendrore për raportet MFTA në drejtim të koordinatorëve të slotëve të aeroportit mbi shërbimet e përsëritura të shërbimeve ajrore, në kohë të ndryshme nga ato të caktuara në slotet e aeroportit ose me përdorimin e slotëve në një mënyrë shumë të ndryshme me atë të treguar në kohën e ndarjes, kur kjo sjell dëmtime për MFTA-në.

Neni 10

Detyrimet në lidhje me ngjarjet kritike

1. AAC-ja duhet të sigurojë që procedurat MFTA për trajtimin e ngjarjeve kritike janë krijuar dhe publikuar nga njësia qendrore për MFTA-në, në mënyrë për të minimizuar ndërprerjen e MFTA-së.

2. Në përgatitje për ngjarjet kritike, njësitë SHTA dhe organet menaxhuese të aeroportit duhet të koordinojnë lidhjen dhe përmbajtjen e procedurave të parashikuara me operatorët e prekur nga



ngjarjet kritike, përfshi çdo rregullim në rregullat prioritare.

Procedurat e ngjarjeve të paparashikuara duhet të përfshijnë:

- a) masat organizative dhe koordinimin;
- b) masat MFTA për të menaxhuar aksesin në zonat e prekura për të parandaluar kërkesat e tepërta të trafikut ajror në krahasim me kapacitetin e deklaruar plotësisht ose pjesërisht të hapësirës ajrore ose aeroporteve në fjalë;
- c) rrethanat, kushtet dhe procedurat për zbatimin e rregullave prioritare për fluturime, në lidhje me sigurinë esenciale të vendit ose interesave të politikës së mbrojtjes;
- d) mënyrat e rikuperimit.

Neni 11

Monitorimi i respektimit të masave MFTA

1. AAC-ja duhet të sigurojë se në rastin kur hyrja në slotet e nisjes MFTA në një aeroport nisjeje është 80% ose më pak gjatë një viti, njësia SHTA në këtë aeroport duhet të japë informacionin e duhur për mosrespektimin dhe veprimet për të siguruar futjen në slotet e nisjes MFTA. Veprime të tilla do të tregohen në një raport që do të paraqitet te Komisioni Evropian, sipas parashikimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

2. Njësia SHTA e aeroportit në fjalë duhet të japë informacionin e duhur për çdo dështim, për t'iu përmbajtur refuzimeve të planit të fluturimit ose pezullimit në atë aeroport dhe të veprimeve të ndërmarra për të siguruar përmbajtjen. Veprime të tilla do të përcaktohen në një raport të paraqitur te Komisioni Evropian, sipas parashikimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

3. AAC-ja duhet të sigurojë, që:

- a) njësia qendrore për MFTA-në njofton vendin tonë, i cili ka aprovuar përjashtime më tepër se 0,6 % të nisjeve vjetore të atij shteti anëtar;
- b) kur vendi ynë është njoftuar sipas pikës “a”, ai duhet të hartojë një raport, duke dhënë detaje të përjashtimeve të dhëna, të cilat do t'i dorëzohen Komisionit.

4. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se kur është identifikuar një jopajtueshmëri me masat e MFTA, të cilat kanë rezultuar nga zbatimi i nenit 5/“g”, njësia qendrore për MFTA-në duhet të njoftojë operatorin për mosrespektimin.

5. Operatorët duhet të paraqesin një raport tek njësia qendrore për MFTA-në për çdo mospërputhje me masat e MFTA-së, duke dhënë detaje të rrethanave që kanë rezultuar në humbjen e planit të fluturimit apo të planeve të shumta të fluturimit dhe veprimeve të ndërmarra për të korrigjuar papajtueshmëri të tilla.

6. AAC-ja duhet të sigurojë që njësia qendrore për MFTA-në përgatit një raport vjetor, i cili siguron detajet të planeve të fluturimeve të munguara apo planeve të fluturimeve të dyfishta për të njëjtin fluturim që janë paraqitur dhe se raporti i është dorëzuar Komisionit.

7. AAC-ja duhet të kryejë një rishikim vjetor të respektimit të masave MFTA, për të siguruar që palët e referuara në nenin 1 (3) kanë përmirësuar nivelin e respektimit të këtyre masave.

Neni 12

Vlerësimi i performancës

1. Kur zbatohet neni 11, AAC-ja duhet të sigurohet që njësia qendrore për MFTA-në përgatit raporte vjetore që tregojnë cilësinë e MFTA-së, të cilat duhet të përfshijnë detaje të:

- a) shkaqeve të masave MFTA;
- b) ndikimit të masave MFTA;
- c) zbatimit të masave MFTA;
- d) kontributeve nga palët e përmendura në nenin 1(3), për përsosjen e ndikimit të rrjetit të përgjithshëm.

2. AAC-të duhet të sigurojnë se është krijuar dhe mbajtur nga njësia qendrore MFTA një arkiv i të dhënave MFTA të renditura në nenin 6(5), planet e fluturimit, dokumentet operationale dhe të dhënat përkatëse kontekstuale janë krijuar dhe mirëmbajtur nga njësia qendrore për MFTA-në.

Të dhënat e përmendura në nënparagrafin e parë do të ruhen për 2 vjet nga data e paraqitjes së tyre dhe do të vihen në dispozicion të Komisionit dhe shteteve anëtare, siç është përcaktuar në Marrëveshjen Shumëpalëshe, njësive SHTA dhe operatorëve. Të dhënat duhet të vihen në dispozicion të koordinatorëve të aeroportit dhe operatorëve të aeroporteve për të ndihmuar në vlerësimin e tyre të rregullt të kapacitetit të deklaruar.



Neni 13

Kërkesat e sigurisë

AAC-ja duhet të sigurojë se është kryer një vlerësim i sigurisë, duke përfshirë identifikimin e rrezikut, vlerësimin e rrezikut dhe zvogëlimin, para çdo ndryshimi domethënës të sistemeve dhe procedurave MFTA, duke përfshirë një vlerësim të procesit të menaxhimit të sigurisë adresuar ciklit të plotë të jetës së sistemit të menaxhimit të trafikut ajror.

Neni 14

Kërkesat shitesë

1. AAC-ja duhet të sigurojë se personeli i palëve, referuar në nenin 1(3) të përfshira në aktivitetet MFTA:

a) janë vënë në dijeni të dispozitave të kësaj rregulloreje;

b) janë trajnuar në mënyrën e duhur; dhe

c) janë kompetent për funksionet e tyre të punës.

2. AAC-ja duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar se palët e referuara në nenin 1(3) me përgjegjësitë për funksionet MFTA-së:

a) zhvillojnë dhe kanë manuale operacionale, të cilat përmbajnë instruksionet dhe informacionet e nevojshme për t'i mundësuar personelit të tyre operacional të aplikojnë dispozitat e kësaj rregulloreje;

b) sigurojnë që këto manuale janë konsistente, të aksesueshme dhe të përditësuara, si dhe përditësimi dhe shpërndarja e tyre janë subjekt për cilësinë e duhur dhe menaxhimin e konfigurimit të dokumenteve;

c) sigurojnë se metodat e punës dhe procedurat operacionale janë në përputhje me këtë rregullore.

Neni 15

Sanksionet

AAC-ja duhet të aplikojë masa administrative të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi, për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato janë zbatuar. Masat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse.

SHTOJCA

Lista e dispozitave të ICAO-s, për qëllime të menaxhimit të fluksit të trafikut ajror

1. Kapitulli 3, paragrafi 3.7.5 (Menaxhimi i Fluksit të Trafikut Ajror) i aneksit 11, të Konventës së Çikagos – Shërbimet e Trafikut Ajror (botimi i 14-të – korrik 2016, që përfshin amendimin nr. 50A).

2. Kapitulli 3 (Kapaciteti i sistemit ATS dhe menaxhimi i fluksit të trafikut ajror) i Dok. 4444, të ICAO-s, Procedurat për Shërbimet e Navigimit Ajror – Menaxhimi i Trafikut Ajror (PANS-ATM) (botimi i 16-të – 2016 që përfshin amendimin nr. 7A).

3. Kapitulli 8, paragrafi 8.3 (Përrjashtimet nga caktimi i slotëve ATFM) i Dok. 7030, të ICAO-s, Procedurat Plotësuese Rajonale Evropiane (EUR) (botimi i 5-të, 2008).

4. Kapitulli 8, paragrafi 8.4 1.c) (mbi respektimin e masave ATFM nga operatorët e avionëve) të Dok. 7030, të ICAO-s, Procedurat Plotësuese Rajonale Evropiane (EUR) (botimi i 5-të, 2008).

5. Kapitulli 2, paragrafi 2.3.2 (mbi ndryshimet në EOBT) të Dok. 7030, të ICAO-s, Procedurat Plotësuese të Rajonit Evropian (EUR) (botimi i 5-të, 2008).

URDHËR**Nr. 782, datë 29.7.2026****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përrjashtuar mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e



thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Đurđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Draž*	
Osjecko-Baranjska	Drenje*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Feričanci*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Našice*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	
Viroviticko-Podavska	Crnac*	
Viroviticko-Podavska	Orahovica*	
Viroviticko-Podavska	Zdenci*	

Shtënimë: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara in vivo të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.



2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime

eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e



përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhëri nr. 757, datë 22.7.2026 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Kroacisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri**

URDHËR

Nr. 788, datë 30.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3*
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempnemarsch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Trübsen*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Münitz*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*
21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Prignitz	Plattinburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*



32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Geldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lenggerich*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Milzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*
53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geiselhöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verden	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großenkneten*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Ved*
59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leezen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Döringen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Domum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempen*
70.	Niedersachsen	Cloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Ostercappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebelta*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardelegen*
75.	Niedersachsen	Emsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donaueschingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wermisdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hammer	Hammer*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*
81.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Weeze*
82.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Goldberg-Mildenitz*
83.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Bützow-Land*
84.	Niedersachsen	Göttingen	Gieboldehausen*
85.	Niedersachsen	Cloppenburg	Essen (Oldenburg)*
86.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow*
87.	Hessen	Gießen	Hungen*
88.	Bayern	Cham	Furth im Wald*
89.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kranenburg*
90.	Sachsen-Anhalt	Jenichow Land	Möckern*
91.	Sachsen	Leipzig	Geithain*
92.	Niedersachsen	Osnabrück	Artland*
93.	Sachsen-Anhalt	Harz	Ostervico*
94.	Brandenburg	Teltow-Fläming	Trebbin*
95.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Eutin*
96.	Brandenburg	Ostprignitz-Ruppin	Heiligengrabe*
97.	Niedersachsen	Cloppenburg	Barfel*
98.	Nordrhein-Westfalen	Hochsauerlandkreis	Meschede*
99.	Thüringen	Kyffhäuserkreis	Kyffhäuserland*
100.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Seelow*
101.	Niedersachsen	Cloppenburg	Eimstek*
102.	Niedersachsen	Leer	Moorerland*
103.	Niedersachsen	Wilhelmshaven	Wilhelmshaven*
104.	Niedersachsen	Bückeburg	Bückeburg*
105.	Sachsen-Anhalt	Börde	Oschersleben (Bode)*
106.	Sachsen	Mittelsachsen	Ostrau*
107.	Brandenburg	Elbe-Elster	Uebigau-Wahrenbrück*
108.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Mecklenburgische Kleinseenplatte*
109.	Bayern	Dachau	Odelzhausen*
110.	Bayern	Schwandorf	Oberveichtach*
111.	Bayern	Regensburg	Sünching*
112.	Niedersachsen	Friesland	Wangerland*

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhëri nr. 631, datë 12.6.2026 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 790, datë 31.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E AUSTRIËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr.



10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Niederösterreich	Baden	Altenmarkt an der Triesting*
Vorarlberg	Bregenz	Lauterach*
Steiermark	Murtal	Pölstal*
Niederösterreich	Melk	Texingtal*
Tirol	Kitzbühel	Brixen im Thale*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me

nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe



ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 509, datë 23.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 791, datë 31.7.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E ÇEKISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Çekisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*
Jihočeský	Prachatic*
Kraj Vysočina	Žďár nad Sázavou*
Pardubický	Svitavy*
Ústecký	Chomutov*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe



ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.



6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 763, datë 24.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Çekisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 793, datë 3.8.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70 °C në 3.6 sekonda;
- iii. 74 °C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Spanjës janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3*
1.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Castello de Rugat*
2.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Ontinyent*
3.	Castilla y León	Valladolid	Valladolid*
4.	Castilla y León	Valladolid	Olmedo*
5.	Castilla y León	Valladolid	Medina del Campo*
6.	Castilla y León	Valladolid	Peñafiel*
7.	Castilla y León	Valladolid	Tordesillas*
8.	Castilla y León	Zamora	Toro*
9.	Castilla y León	Segovia	Cuellar*
10.	Castilla y León	Ávila	San Pedro del Arroyo*
11.	Castilla y León	Salamanca	Peñaranda de Bracamonte*
12.	Castilla y León	Segovia	Santa Maria la Real de Nieva*

Shënime: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Spanjës të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.



4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikes 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhëri nr. 758, datë 22.7.2026 *“Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Spanjës”*, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 796, datë 4.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2*
1.	Kansas	Pratt*
2.	Indiana	Elkhart*
3.	Indiana	Noble*
4.	Indiana	LaGrange*
5.	Arkansas	Clay*
6.	South Dakota	Edmunds*
7.	North Dakota	Dickey*
8.	Utah	Cache*
9.	Idaho	Canyon*

Shënime: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të



shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhëri nr. 751, datë 20.7.2026 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 797, datë 4.8.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN
E RUMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2*
1.	Mureş	Voivodeni*
2.	Mureş	Vatava*
3.	Mureş	Zau De Campie*
4.	Mureş	Suseni*
5.	Buzău	Padina*
6.	Iaşi	Popesti*

Shënime: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhëri nr. 708, datë 8.7.2026 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHER
Nr. 1593, datë 31.7.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE
ZËVENDËSMINISTRIT TË MBROJTJES,
Z. ENKELEJDI JOTI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit nr. 518, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejd Joti, me porosi, në rastin e mungesës afatshkurtër, për ushtrimin e kompetencave në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë:

a) miradministrimin dhe zhvillimin e pronave të paluajtshme të mbrojtjes, me qëllim maksimizimin e funksionalitetit në shërbim të Forcave të Armatosura, si dhe rritjes së eficiencës së tyre ekonomike;

b) emergjencat civile;

c) mjekësinë ushtarake.

2. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë, monitorojë, koordinojë me institucionet e varësisë, agjencitë autonome, drejtoritë në përbërje të ministrisë dhe të përgjigjet përpara ministrit, mbi:

a) zhvillimin dhe zbatimin e politikave për miradministrimin, zhvillimin dhe përdorimin eficient të pronave të paluajtshme të mbrojtjes, në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe eficiencës së Forcave të Armatosura;

b) koordinimin dhe monitorimin e politikave në fushën e mjekësisë ushtarake, përfshirë inovacionin dhe përmirësimin e kapaciteteve mbështetëse në këtë fushë;

c) zhvillimin dhe zbatimin e politikave për nxitjen e inovacionit, teknologjisë dhe projekteve strategjike në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe kontrollit të territorit;

ç) koordinimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në fushat e deleguara të përgjegjësisë;

d) mbikëqyrjen e performancës dhe raportimeve periodike të strukturave përgjegjëse në fushat e deleguara sipas këtij urdhri.

3. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë mbikëqyrjen e performancës dhe raportimet periodike të institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome.

4. Zëvendësministri raporton me shkrim te ministri për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë urdhër sipas kërkesës së ministrit dhe të paktën 1 (një) herë në javë për detyrat dhe përgjegjësitë e deleguara sipas këtij urdhri dhe ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

5. Zëvendësministri, sipas parashikimeve të këtij urdhri, autorizohet të nënshkruajë:

a) akte shkresore të iniciuara në nivel zëvendësministri brenda fushave të përgjegjësisë, si dhe ato në përmbushje të marrëveshjeve të nënshkruara;

b) akte shkresore që lidhen me plotësimin e detyrimeve që rrjedhin në cilësinë e tij të anëtarit apo kryetarit të grupeve të punës;

c) çdo shkresë/akt/procedurë shkresore tjetër me autorizim të posaçëm të ministrit.

6. Kompetencat e deleguara sipas këtij urdhri ushtrohen në përputhje me ndarjen e fushave të përgjegjësisë të përcaktuara për zëvendësministrat e tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Çdo akt tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

8. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.



9. Ngarkohen zëvendësministri, z. Enkelejd Joti, institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë e aparatit në përbërje të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri, sipas njoftimeve përkatëse për mungesën afatshkurtër të ministrit.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi

URDHËR

Nr. 1594, datë 31.7.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE ZËVENDËSMINISTRIT TË MBROJTJES, ZNJ. BLERINA ABRAZHDA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit nr. 518, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, me porosi, në rastin e mungesës afatshkurtër, për ushtrimin e kompetencave në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë:

- a) industria ushtarake e Republikës së Shqipërisë;
- b) procesi i modernizimit me kapacitete të avancuara;
- c) mbikëqyrja e marrëdhënieve NATO–BE;
- d) pjesëmarrja e Ministrisë së Mbrojtjes në organizata dhe nisma ndërkombëtare.

2. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë, monitorojë, koordinojë me institucionet e varësisë, agjencitë autonome, drejtoritë në përbërje të ministrisë dhe të përgjigjet përpara ministrit, mbi:

a) zhvillimin e kapaciteteve operacionale, njerëzore dhe infrastrukturore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet koordinimit dhe monitorimit të politikave të modernizimit dhe zhvillimit institucional;

b) hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e industrisë ushtarake, përfshirë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në këtë fushë;

c) koordinimin dhe harmonizimin e politikave dhe prioritetëve që lidhen me zhvillimin strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

ç) ndjekjen e programeve dhe projekteve që lidhen me modernizimin institucional dhe operacional në sektorin e mbrojtjes;

d) mbikëqyrjen e performancës dhe raportimeve periodike të strukturave përgjegjëse në fushat e deleguara të përgjegjësisë.

3. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë mbikëqyrjen e performancës dhe raportimet periodike të institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome.

4. Zëvendësministri raporton me shkrim te ministri për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë urdhër sipas kërkesës së ministrit dhe të paktën 1 (një) herë në javë për detyrat dhe përgjegjësitë e deleguara sipas këtij urdhri dhe ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

5. Zëvendësministri, sipas parashikimeve të këtij urdhri, autorizohet të nënshkruajë:

a) akte shkresore të iniciuara në nivel zëvendësministri brenda fushave të përgjegjësisë, si dhe ato në përmbushje të marrëveshjeve të nënshkruara;

b) akte shkresore që lidhen me plotësimin e detyrimeve që rrjedhin në cilësinë e tij të anëtarit apo kryetarit të grupeve të punës;

c) çdo shkresë/akt/procedurë shkresore tjetër me autorizim të posaçëm të ministrit.

6. Kompetencat e deleguara sipas këtij urdhri ushtrohen në përputhje me ndarjen e fushave të përgjegjësisë të përcaktuara për zëvendësministrat e tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes.



7. Çdo akt tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

8. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

9. Ngarkohen zëvendësministrija, znj. Blerina Abrazhda, institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë e aparatit në përbërje të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri, sipas njoftimeve përkatëse për mungesën afatshkurtër të ministrit.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi

URDHËR
Nr. 1595, datë 31.7.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE
ZËVENDËSMINISTRIT TË MBROJTJES,
ZNJ. PRANVERA SKANA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit nr. 518, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana, me porosi, në rastin e mungesës afatshkurtër, për ushtrimin e kompetencave në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë:

- a) arsimin ushtarak;
- b) bashkëpunimin civilo-ushtarak;

c) inovacionin.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë, monitorojë dhe koordinojë veprimtarinë e institucioneve të varësisë, agjencive autonome dhe drejtorive në përbërje të ministrisë, si dhe të përgjigjet përpara ministrit, lidhur me:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave në fushat e deleguara të përgjegjësisë, përfshirë negocimin dhe implementimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale;

b) zhvillimin dhe zbatimin e politikave për nxitjen e inovacionit në funksion të arsimit ushtarak dhe mbrojtjes civile;

c) koordinimin e politikave që lidhen me zhvillimin institucional dhe teknologjik në funksion të fushave të deleguara sipas këtij urdhri;

ç) orientimin dhe harmonizimin e politikave për fushat e deleguara të përgjegjësisë.

3. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë mbikëqyrjen e performancës dhe raportimet periodike të institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome.

4. Zëvendësministri raporton me shkrim te ministri për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë urdhër sipas kërkesës së ministrit dhe të paktën 1 (një) herë në javë për detyrat dhe përgjegjësitë e deleguara sipas këtij urdhri dhe ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

5. Zëvendësministri, sipas parashikimeve të këtij urdhri, autorizohet të nënshkruajë:

a) akte shkresore të iniciuara në nivel zëvendësministri brenda fushave të përgjegjësisë, si dhe ato në përmbushje të marrëveshjeve të nënshkruara;

b) akte shkresore që lidhen me plotësimin e detyrimeve që rrjedhin në cilësinë e tij të anëtarit apo kryetarit të grupeve të punës;

c) çdo shkresë/akt/procedurë shkresore tjetër me autorizim të posaçëm të ministrit.

6. Kompetencat e deleguara sipas këtij urdhri ushtrohen në përputhje me ndarjen e fushave të përgjegjësisë të përcaktuara për zëvendësministrit e tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Çdo akt tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

8. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.



9. Ngarkohen zëvendësministria, znj. Pranvera Skana, institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë e aparatit në përbërje të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri, sipas njoftimeve përkatëse për mungesën afatshkurtër të ministrit.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi

KËRKESE

Shtetasja Flora Virjoni kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, shpalljen të vdekur të shtetasit Muhamet Virjoni, me atësi Besim dhe amësi Xhemile, i datëlindjes 15.6.1956, lindur në Tiranë dhe banues në Durrës.

KËRKUESE
Flora Virjoni



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 176]Datë: 10.08.2026 11:28:05
+02:00]0198fcaf-cde6-4f3b-91a6-523139c1ae38

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)